



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



---

# **ZGJEDHJET NË KOSOVË**

## **2000 - 2014**

---

**Prishtinë, 2017**

**Botues**

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

*Për më shumë informacion kontaktoni Sekretariatit e KQZ-së:*

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Telefoni: +381 (0) 38 211 034

E-mail: [infokqz@kqz-ks.org](mailto:infokqz@kqz-ks.org)

Uebfaqe: [www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org)

© Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Ky dokument, në formë raporti, u hartua nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Dokumenti përmban të dhënat për zgjedhjet e organizuara nga viti 2000 deri në vitin 2014.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) ka siguruar të dhënat për proceset zgjedhore në periudhën 2000 – 2007.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve falënderon Misionin e OSBE-së në Kosovë për ndihmën e dhënë në sigurimin e këtyre të dhënave dhe mbështetjen financiare për shtypjen e këtij botimi.

## PËRMBAJTJA

HYRJE .....	7
PJESA I - HISTORIKU .....	9
KAPITULLI I - SISTEMI ZGJEDHOR	
Informata të përgjithshme .....	11
KAPITULLI II - ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	
Përgatitje të procesit zgjedhor .....	21
KAPITULLI III - REGJISTRIMI I VOTUESVE	
Regjistrimi i votuesve .....	29
KAPITULLI IV - REGJISTRIMI I PARTIVE POLITIKE, CERTIFIKIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE DHE KANDIDATËVE	
Të dhëna për partitë politike .....	35
KAPITULLI V - AKREDITIMI I VËZHGUESVE	
Të dhëna mbi procesin e vëzhgimit të zgjedhjeve .....	39
KAPITULLI VI - VOTIMI, NUMËRIMI DHE REZULTATET	
Procesi i votimit .....	41
KAPITULLI VII - MJETET JURIDIKE	
Korigjimi, sanksionimi, gjykimi në procesin zgjedhor .....	59
PJESA II – PROCEDURA ZGJEDHORE .....	65
PËRFUNDIMI .....	85

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Periudha kohore – Ciklet dhe Ngjarjet 2000 - 2014.....	14
Tabela 2: Sistemi – Pasqyrë e përgjithshme .....	16
Tabela 2: Sistemi – Pasqyrë e përgjithshme (vazhdim) .....	18
Tabela 3: Ulëset në Kuvende Komunale 2000-2014.....	19
Tabela 4: Periudha kohore ndërmjet shpalljes dhe certifikimit të rezultateve.....	23
Tabela 5: Numri i qendrave të votimit/vendvotimeve 2000-2007 sipas komunave .....	24
Tabela 6: Numri i qendrave të votimit/vendvotimeve 2009-2014 sipas komunave .....	26
Tabela 7: Votuesit – Elektorati sipas komunave 2000-2007 .....	32
Tabela 8: Votues – Elektorati sipas komunave 2009–2014 .....	33
Tabela 9: Partitë politike të regjistruara dhe të çregjistruara.....	37
Tabela 10: Certifikimi i Subjekteve Politike .....	38
Tabela 11: Akreditimi i Vëzhguesve.....	40
Tabela 12: Programet e votimit.....	44
Tabela 13: Përmbledhje e daljes në zgjedhje, ndarjeve të fletëvotimeve, si dhe komunave të certifikuar (2000-2007) .....	45
Tabela 14: Përmbledhje e daljes në zgjedhje, ndarjeve të fletëvotimeve dhe komunave të certifikuar (2009-2014) .....	47
Tabela 15: Përfaqësimi nga deputetët e Kuvendit të Kosovës 2001.....	49
Tabela 16: Përfaqësimi nga deputetët e Kuvendit të Kosovës 2004 .....	51
Tabela 17: Përfaqësimi nga deputetët e Kuvendit të Kosovës 2007 .....	53
Tabela 18: Përfaqësimi nga deputetët e Kuvendit të Kosovës 2010.....	55

Tabela 19: Përfaqësimi nga deputetët e Kuvendit të Kosovës 2014.....	56
Tabelë përmbledhëse e deputetëve të Kuvendit të Kosovës sipas gjinisë dhe etnisë nga viti 2001 – 2014 .....	57
Tabela 20: Mjetet juridike .....	64
Tabela 21: Aktivitetet kryesore të zgjedhjeve .....	66
Tabela 22: Shpallja dhe mbajtja e zgjedhjeve për Kuvend të Kosovës.....	72
Tabela 23: Shpallja dhe mbajtja e zgjedhjeve lokale.....	73
Tabela 24: Procesi i regjistrimit të partive politike.....	74
Tabela 25: Procesi i certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve .....	75
Tabela 26: Partitë Politike – Kërkesat ligjore .....	76
Tabela 27: Numri minimal i kandidatëve të nominuar nga gjinia e kundërt/Zgjedhjet lokale.....	77
Tabela 28: Numri minimal i kandidatëve nga gjinia e kundërt / Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.....	78
Tabela 29: Emërimi i Komisionit Komunal Zgjedhor .....	79
Tabela 30: Emërimi i anëtarëve të Komisionit të Vendvotimit .....	80
Tabela 31: Hapat në numërimin e votave në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës....	81
Tabela 32: Metoda e ndarjes së ulëseve për zgjedhjet e anëtarëve të Kuvendit të Kosovës .....	82
Tabela 33: Procedura e ankesave dhe parashtresave.....	83



## HYRJE

Kosova ka shënuar përparime të mëdha në fushën e zgjedhjeve. Historia e zgjedhjeve në Kosovën e pasluftës, fillon në vitin 2000. Më 28 tetor të atij viti, u mbajtën zgjedhjet e para për Kuvendet Komunale. Një vit më pas, më 17 nëntor 2001 u mbajtën, gjithashtu për herë të parë, zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.

Deri në shpalljen e Pavarësisë së Kosovës (2008), u organizuan edhe disa procese tjera zgjedhore.

Karakteristikat e sistemit zgjedhor, të dizajnuara në vitin 2000, mbetën të pandryshuara gjatë kësaj kohe. Ndryshimet më të rëndësishme ndodhën me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.

Në fushën e zgjedhjeve, mund të përmendim disa elemente që e karakterizojnë Republikën e Kosovës: përdorimi i përkohshëm i sistemit me lista të mbyllura; futja e pragut zgjedhor; heqja e votimit në mungesë; zhvillimet në regjistrin e votuesve; dhe ndryshimet në përbërjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Gjatë kësaj periudhe, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka arritur të organizoj disa procese zgjedhore, të plota apo të pjesshme, duke arritur të përmbushë detyrimet kushtetuese dhe ligjore.

Gjithashtu, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka arritur të bëhet anëtar me të drejta të plota në A-WEB (Asociacioni i Zyrtarëve Zgjedhor Botëror) dhe ACEEEO (Asociacioni i Zyrtarëve Zgjedhor European), duke u bashkuar me dhjetëra trupa tjera menaxhuese të zgjedhjeve nga mbarë bota.

Ky publikim, është vazhdimësi e shprehjes së përkushtimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për avancimin e proceseve zgjedhore në Republikën e Kosovës. Të dhënat që ofrohen në këtë publikim, përveç akterëve që merren me zgjedhjet, do të mund t'iu shërbejnë edhe studiuesve të ndryshëm për hulumtime të kësaj fushe.

Në këtë publikim, të ndarë në disa kapituj, do të ofrohen informacione për administrimin e zgjedhjeve; sistemin zgjedhor; si dhe të dhëna statistikore për regjistrimin e votuesve; partive politike dhe certifikimin e subjekteve politike. Po ashtu, një hapësirë e veçantë i është dhënë procesit të votimit; numërimit dhe rezultateve.

Të dhënat që janë prezantuar në këtë publikim, kanë edhe shpjegimet e nevojshme për t'i ndihmuar lexuesve në interpretimin dhe krahasimin e tyre.



## PJESA I - HISTORIKU

*(Pjesa e parë e këtij raporti, pasqyron të dhënat e zgjedhjeve që janë organizuar në Kosovë nga viti 2000 deri në vitin 2014)*

Proceset e zgjedhjeve të lira dhe demokratike në Republikën e Kosovës, pasqyrojnë në shkallë të lartë procesin e ndërtimit dhe të konsolidimit të institucioneve të ligjshme dhe demokratike. Ky raport, pasqyron të dhënat e zgjedhjeve që janë organizuar në vendin tonë nga viti 2000 deri në vitin 2014. Gjatë kësaj periudhe, në aspektin e organizimit të zgjedhjeve Republika e Kosovës është përballur me shumë sfida dhe ka shënuar zhvillime të mëdha në fushën e zgjedhjeve, ndonëse elementet kryesore të sistemit zgjedhor kanë mbetur të pandryshuara gjatë gjithë kësaj kohe.

Karakteristikat kryesore të sistemit zgjedhor të dizajnuar në vitin 2000, ishin si vijon:

- a) Në rastin e zgjedhjeve për kuvende (si për kuvende komunale ashtu dhe për Kuvend të Kosovës) ka pasur sistem proporcional të përfaqësimit me formulë favorizuese për partitë politike të mesme ose të vogla, ndërsa në rastin e zgjedhjeve për kryetar komune është përdorur sistemi mazhoritar.
- b) Legjislacioni zgjedhor ka qenë mjaft përfshirës edhe për sa i përket elektoratit edhe subjekteve politike të cilat kanë garuar për zgjedhje dhe programeve të votimit që kanë lehtësuar ushtrimin e së drejtës së votës, si dhe në parapëlqimin e sistemit të votimit preferencial.
- c) Ideja për promovimin e gjinisë më pak të përfaqësuar në proces (veçanërisht si kandidatë dhe përfaqësues të zgjedhur) ka qenë e pranishme që nga fillimi.
- d) Komunitetet joshumicë kanë pasur trajtim të posaçëm në formë të ulëseve të veçanta të siguruara dhe rregullave të ndarjes së ulëseve sipas preferences.
- e) Gjatë kësaj periudhe, struktura e administratës zgjedhore ka treguar përimirësim të vazhdueshëm.

Krahas këtij procesi substancial në ndërtimin e shoqërisë demokratike, ka pasur vazhdimisht hapa inkurajues në ndërtimin dhe forcimin e institucioneve demokratike. Në kontekst, mund të themi që ndryshimi më i rëndësishëm, do të thoshim “ndryshimi historik” erdhi me shpalljen e pavarësisë së vendit dhe me transferimin e pushtetit tek autoritetet kosovare.

Sa u përket elementeve të sistemit zgjedhor, mund të përmendim (mes tjerash), përdorimin e përkohshëm të sistemit me Lista të Mbyllura, futja e Pragut Ligjor për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetin shumicë, heqja Votimit në Mungesë, dhe gjithashtu edhe përpilimi dhe ndërtimi i Regjistrimit të votuesve, ndryshimet në pushtetin e regjistrimit të Partisë Politike, ndryshimet në përbërjen e Organeve Menaxhuese Zgjedhore, ndryshimin në sistemin e Mjeteve Juridike, etj.

Të gjitha këto çështje, e të cilat e përbëjnë boshtin parësorë të gjithë procesit të zgjedhjeve, do t'i shpjegojmë në kapitujt vijues. Prandaj, ndryshimet e sipërpërmendura si dhe ndryshimet në metodën e punës së organeve menaxhuese zgjedhore, dhe në kuadër të kësaj, edhe ndryshimet e kohëpaskohshme të kategorizimit të të dhënave në veçanti, e bëjnë goxha të vështirë sistemimin dhe pasqyrimin e plotë të të dhënave në dispozicion.

Parimi i kësaj përmbledhjeje, është që këto të dhëna janë të prezantuara ashtu siç ishin në dispozicion. Sipas nevojës, është dhënë edhe shpjegim për t'i ndihmuar lexuesit në interpretimin dhe përdorimin eventual të tyre.

Burimet e të dhënave, janë dokumentet zyrtare të Misionit të OSBE-së në Kosovë (për periudhën 2000, deri në 2007), si dhe ato të KQZ-së dhe PZAP-së për periudhën nga viti 2008, që përfshinë periudhën e proceseve zgjedhore që janë organizuara nga viti 2009 deri në vitin 2014

## KAPITULLI I - SISTEMI ZGJEDHOR

### Informata të përgjithshme

Ky kapitull, në fakt përmban informata të përgjithshme për zgjedhjet e mbajtura në Kosovë që nga viti 2000. Në këtë kapitull, përfshihen informatat për:

- Proceset zgjedhore,
- Sistemet e aplikuara zgjedhore,
- Numrin e ulëseve dhe kuotës gjinore në kuvende,
- Informata bazike për elektoratin dhe pjesëmarrjen në zgjedhje,
- Hapat kryesorë në aktivitetet zgjedhore.

Në periudhën nga viti 2000 e deri në vitin 2014, janë mbajtur dhjetë (10) cikle zgjedhore: pesë (5) për Kuvendin e Kosovës, dhe pesë (5) për kuvende komunale, duke përfshirë 3 cikle nga viti 2007 kur kryetarët e komunave janë zgjedhur drejtpërdrejt.

Që nga viti 2009 ka pasur shumë ngjarje zgjedhore brenda një cikli të caktuar zgjedhor (raunde të dyta në zgjedhje për kryetarë të komunave, zgjedhje të përsëritura si rezultat i mjeteve të shfrytëzuara ligjore kundër rezultateve, zgjedhje të jashtëzakonshme) që ka çuar numrin e ngjarjeve (procese) zgjedhore në mbi 30 gjatë viteve 2000-2014. (Tabela 2 përmbledh karakteristikat kryesore të sistemit zgjedhor që nga viti 2000).

Sistemi zgjedhor, në kuptim më të ngushtë, është grup i dispozitave ligjore që shndërrojnë votën e dhënë gjatë zgjedhjeve në ulëse të fituara nga partitë politike dhe kandidatët. Variablat kryesore të një sistemi zgjedhor janë formulat zgjedhore të përdorura, struktura e fletëvotimit dhe madhësia e zonës zgjedhore.

Praktikisht, që nga viti 2000 janë përdorur dy sisteme zgjedhore gjatë zgjedhjeve (krahaso rreshtat 1 dhe 8 të tabelës 2).

Për zgjedhjet e anëtarëve të kuvendeve (qofshin komunale apo për Kuvend të Kosovës), Kosova ka përdorur një sistem të Listave të Partive me Përfaqësim Proporcional, gjegjësisht sistemin e koeficientit më të lartë me

përdorim të metodës Sainte-Laguë. Në këtë metodë të ndarjes së ulëseve, numri gjithsej i fletëvotimeve të vlefshme për secilin subjekt politik që garon në zgjedhje pjesëtohet sipas numrave vijues tekë (1, 3, 5, 7, 9 etj.) për të nxjerrë koeficientin, siç sqarohet në shembullin e paraqitur në tabelën 32 në Pjesën II. Koeficientët më të lartë (p.sh. 120 më të lartët në renditje në rastin e Kuvendit të Kosovës), përcaktojnë numrin e ulëseve për secilin subjekt dhe renditjen se si ndahen ato.

Krahas votimit për subjektin politik (shih: rreshti 3 i tabelës 2), me tre përjashtime (2001, 2002, 2004) votuesit kanë mundur të votojnë kandidatin/tët e tyre të preferuar në fletëvotim (listë e hapur) dhe renditja përfundimtare e kandidatëve realizohet në renditje nga fundi i votave preferenciale për kandidatët por duke e marrë parasysh kërkesën gjinore (shih më poshtë).

Që nga viti 2009, për zgjedhjen e anëtarëve të kuvendeve komunale, është zbatuar një variant special i sistemit të listës së hapur: votuesi nuk mund t'ia jep votën preferenciale udhëheqësit të listës (kandidatit nr. 1 në listë) por vetëm për kandidatët e tjerë, ndërkohë që udhëheqësi i listës konsiderohet të ketë marrë votën preferenciale me automatizëm. Në rastin e sistemit me listë të mbyllur, votuesi nuk mund të jep votën preferenciale dhe kandidatët marrin mandatin në renditjen e përcaktuar nga subjekti politik para zgjedhjeve.

Sa u përket zgjedhjeve për deputetë të Kuvendit, Kosova përbën një zonë të vetme zgjedhore (të gjithë votuesit marrin nga një fletëvotim të njëjtë), ndërsa për zgjedhjet për anëtarë të kuvendeve komunale, komuna përbën një zonë të vetme zgjedhore (shih: rreshti 4 i tabelës 2).

Që nga viti 2007, subjektet politike të shqiptarëve të Kosovës të cilat garojnë në zgjedhje për Kuvend të Kosovës është dashur të fitojnë së paku 5% të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme për të marrë pjesë në ndarjen e ulëseve (Pragu zgjedhor. Shih: rreshti 7 i tabelës 2).

Për zgjedhjet e kuvendeve komunale, nuk ka prag zgjedhor. (Rreshti 5 i tabelës 2 tregon numrin gjithsej të ulëseve/mandateve për të cilat garojnë kandidatët, siç përcaktohet nga legjislacioni i aplikueshëm. Disa ulëse, nuk janë plotësuar për arsye të ndryshme: shih fusnotat për këtë tabelë. Ndarja e numrit

të ulëseve në kuvendet komunale, dhe ndryshimet e tyre, mund të gjinden në një tabelë të veçantë, tabela 4).

Që nga viti 2000, nën kushte të ndryshme – komuniteteve jo shumicë u janë ndarë ulëse në Kuvendin e Kosovës, nga 20 sosh në çdo Kuvend (shih për krahasim rreshti 6 i tabelës 2). Sistemi i ulëseve të rezervuara, i përdorur deri në vitin 2010, nënkuptonte që subjektet politike të komuniteteve jo shumicë fitonin ulëse krahas ulëseve të fituara në mënyrë të rregullt në garën zgjedhore (nëse fitonin të tilla). Ndërsa sistemi i ulëseve të garantuara, i aplikuar që nga viti 2014, nënkupton që komunitetet jo shumicë kanë garuar kryesisht për këtë numër ulësesh.

Për zgjedhjet për kryetar komune (që nga 2007), është përdorur një sistem zgjedhor mazhoritar “Sistemi me dy raunde” (shih: rreshtat 1 dhe 8 të tabelës 2): për t’u zgjedhur, kandidati duhet të fitojë më shumë se gjysmën e votave të vlefshme dhe, nëse kjo nuk arrihet gjatë raundit të parë, atëherë mbahet një raund i dytë ndërmjet kandidatëve që kanë marrë numrin më të lartë të votave gjatë raundit të parë.

Kuotat gjinore në listat e partive (shih: rreshti 9 i tabelës 2) janë zbatuar për listën e kandidatëve të partive politike nga viti 2000. Kjo kuotë, ka qenë 33% për sa i përket 67% të kandidatëve të parë në listën e kandidatëve nga viti 2001 deri në 2004. Ndërkaq, 30% për sa i përket numrit të përgjithshëm të kandidatëve të emëruar (apo për sa i përket 15 kandidatëve të parë vetëm në vitin 2000) në rastin e zgjedhjeve të tjera. Tabelat e veçanta në Pjesën II (Tabelat 27-28) tregojnë se si duhet të zbatohen këto dispozita.

Kuota gjinore për rezultate, është aplikuar nga viti 2001 e tutje, dhe ajo aplikohet vetëm për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës dhe për kuvende komunale. Nuk ka pasur kuota për listat e partive apo për rezultate për zgjedhje për kryetar komune. (Tabela 3 sqaron se, sa ulëse kanë qenë në çdo kuvend komunal që nga viti 2000 (shih rreshtin 5 të tabelës 2, po ashtu).

Tabela 1: Periudha kohore – Ciklet dhe Ngjarjet 2000 - 2014

CIKLI	NGJARJET	DATA E MBAJTJES
Kuvendi Komunal #1	ZGJEDHJET PËR KUVEND KOMUNAL	28 tetor 2000
Kuvendi i Kosovës #1	ZGJEDHJET PËR KUVEND TË KOSOVËS	17 nëntor 2001
Kuvendi Komunal #2	ZGJEDHJET PËR KUVEND KOMUNAL	26 tetor 2002
Kuvendi i Kosovës #2	ZGJEDHJET PËR KUVEND TË KOSOVËS	23 tetor 2004
Kuvendi i Kosovës #3	ZGJEDHJET PËR KUVEND TË KOSOVËS	17 nëntor 2007
Kuvendi Komunal #3	ZGJEDHJET PËR KUVEND KOMUNAL	17 nëntor 2007
	ZGJEDHJET PËR KRYETARË TË KOMUNAVE	17 nëntor 2007
	RAUNDI I DYTË I ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR KOMUNE	08 dhjetor 2007
Kuvendi Komunal #4	ZGJEDHJET PËR KUVEND KOMUNAL	15 nëntor 2009
	ZGJEDHJET PËR KRYETAR KOMUNE	15 nëntor 2009
	RAUNDI I DYTË I ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR KOMUNE	13 dhjetor 2009
	PËRSËRITJE E ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR KOMUNE (PRIZREN)	31 janar 2010
	PËRSËRITJE E ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR KOMUNE (LIPJAN)	31 Janar 2010
	PËRSËRITJE E ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR KOMUNE (GJILAN)	14 mars 2010
	ZGJEDHJE TË JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR KOMUNE (ISTOG)	11 prill 2010
	RAUNDI I DYTË I ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR KOMUNE (ISTOG)	09 maj 2010
	ZGJEDHJE PËR KUVEND KOMUNAL (PARTESH)	20 qershor 2010
	ZGJEDHJET PËR KRYETAR KOMUNE (PARTESH)	20 qershor 2010

	RAUNDI I DYTË PËR KRYETAR KOMUNE (PARTESH)	18 korrik 2010
	ZGJEDHJE TË JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR KOMUNE (RAHOVEC)	21 nëntor 2010
	RAUNDI I DYTË I ZGJEDHJEVE TË JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR KOMUNE	19 dhjetor 2010
	ZGJEDHJE TË JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR KOMUNE (FERIZAJ)	29 prill 2012
	RAUNDI I DYTË I ZGJEDHJEVE TË JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR KOMUNE	27 maj 2012
	ZGJEDHJE TË JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR KOMUNE (KACANIK)	17 qershor 2012
Kuvendi i Kosovës #4	ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVEND TË KOSOVËS	12 dhjetor 2010
	PËRSËRITJE E ZGJEDHJEVE (SKENDERAJ)	09 janar 2011
	PËRSËRITJE E ZGJEDHJEVE (GLLOGOVC)	09 janar 2011
	PËRSËRITJE E ZGJEDHJEVE (DEÇAN)	09 janar 2011
	PËRSËRITJE E PJESSHME E ZGJEDHJEVE (MALISHEVË)	09 janar 2011
	PËRSËRITJE E PJESSHME E ZGJEDHJEVE (LIPJAN)	09 janar 2011
	PËRSËRITJE E PJESSHME E ZGJEDHJEVE (MITROVICË)	23 janar 2011
Kuvendi Komunal #5	ZGJEDHJET PËR KUVEND KOMUNAL	3 nëntor 2013
	ZGJEDHJET PËR KRYETAR KOMUNE	3 nëntor 2013
	PËRSËRITJE E PJESSHME E ZGJEDHJEVE (ZVEÇAN, MITROVICA VERIORE, PARTESH)	17 nëntor 2013
	RAUNDI I DYTË PËR KRYETAR KOMUNE I	01 dhjetor 2013
	ZGJEDHJEVE TË JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR KOMUNE (MITROVICA VERIORE)	23 shkurt 2014
Kuvendi i Kosovës #5	ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVEND TË KOSOVËS	08 qershor 2014

Tabela 2: Sistemi – Pasqyrë e përgjithshme

	KUVENDI KOMUNAL 2000	KUVENDI I KOSOVËS 2001	KUVENDI KOMUNAL 2002	KUVENDI I KOSOVËS 2004	KUVENDI I KOSOVËS 2007	KUVENDI KOMUNAL 2007	KRYETAR KOMUNE 2007
1. Sistemi zgjedhor	Lista e Partisë Përfaqësim Proporcional	Lista e Partisë Përfaqësim Proporcional	Lista e Partisë Përfaqësim Proporcional	Lista e Partisë Përfaqësim Proporcional	Lista e Partisë Përfaqësim Proporcional	Lista e Partisë Përfaqësim Proporcional	Pluralist / Mazhoritar
2. Lista e kandidatëve	Hapur	Mbyllur	Mbyllur	Mbyllur	Hapur	Hapur	Hapur
3. Votimi për:	Subjekti dhe një kandidat	Vetëm subjekti	Vetëm subjekti	Vetëm subjekti	Subjekti dhe deri në 10 kandidatë	Subjekti dhe deri në 10 kandidatë	Vetëm një kandidat
4. Zonat	30	Një i vetëm	30	30	Një i vetëm	30	30
5. Gjithsej ulëse sipas legjislacionit <sup>1</sup>	920	120	920	120	120	920	30
6. Ulëset e veçanta	N/Z	20	N/Z	20	20	N/Z	N/Z

<sup>1</sup> Në vitin 2000 rezultatet nga zgjedhjet për kuvendin komunal nga Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok nuk u certifikuan. Vetëm 94.4% e ulëseve, 869 nga 920, u certifikuan në 27 nga 30 komuna. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP KB) emëroi përfaqësuesit. Në 2007 rezultatet e zgjedhjeve komunale në Novobërdë, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Shtërpçë nuk u certifikuan. Vetëm 90.8% e ulëseve, 835 nga 920, u certifikuan në 25 nga 30 komuna. Për më tepër, rezultat për kryetar komune në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Shtërpçë nuk u certifikuan. Vetëm 86.7% e posteve të kryetarëve të komunave, gjegjësisht 26 nga 30 u certifikuan. Përfaqësuesi i emëroi PSSP i OKB-së.



7. Pragu	—	—	—	—	5%	—	N/Z
8. Metoda e ndarjes së ulëseve	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)	Sistem me dy runde (balotazh)
9. Kuota gjinore	30%	33%	33%	33%	30%	30%	N/Z

*Burimi: Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/39 për zgjedhjet komunale në Kosovë; Rregullorja e nr. 2001/33 për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës; Rregullorja e UNMIK nr. 2002/11 për Zgjedhjet komunale në Kosovë; Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/12 për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës; Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2007/26 që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/12 për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës.*

Tabela 2: Sistemi – Pasqyrë e përgjithshme (vazhdim)

	KUVENDI KOMUNAL 2009	KRYETAR KOMUNE 2009	KUVENDI I KOSOVËS 2010	KUVENDI KOMUNAL 2013	KRYETAR KOMUNE 2013	KUVENDI I KOSOVËS 2014
1. Sistemi zgjedhor	Lista e Partisë Përfaqësimit Proporcional	Pluralist / Mazhoritar	Lista e Partisë Përfaqësimit Proporcional	Lista e Partisë Përfaqësimit Proporcional	Pluralist / Mazhoritar	Lista e Partisë Përfaqësimit Proporcional
2. Lista e kandidatëve	Hapur	N/Z	Hapur	Hapur	N/Z	Hapur
3. Votimi për:	Subjektin dhe vetëm një kandidat	Vetëm një kandidat	Subjektin dhe deri në 5 kandidatë	Subjektin dhe vetëm një kandidat	Vetëm një kandidat	Subjektin dhe deri në 5 kandidatë
4. Zonat <sup>2</sup>	36	36	Një e vetme	38	38	Një e vetme
5. Gjithsej ulëse sipas legjislacionit <sup>3</sup>	1,021	36	120	994 <sup>4</sup>	38	120
6. Ulëset e veçanta	N/Z	N/Z	20	20	N/Z	20
7. Pragu	—	N/Z	5%	—	N/Z	5%
8. Metoda e ndarjes së ulëseve	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)	Sistem me dy raunde (balotazh)	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)	Sistem me dy raunde (balotazh)	Koeficienti më i lartë (Sainte-Laguë)
9. Kuota gjinore	30%	N/Z	30%	30%	N/Z	30%

Burimi: Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar

<sup>2</sup> Zona e 37 zgjedhore në zgjedhjet komunale/kryetar komune në Partesh u krijua në 2010, pas zgjedhjeve të vitit 2009.

<sup>3</sup> Në 2009, rezultatet për zgjedhjet komunale dhe për kryetar komune në Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan nuk u certifikuan. Vetëm 94% e ulëseve, gjegjësisht 964 nga 1,021 u certifikuan në 33 nga 36 komunat dhe 91.7% të posteve për kryetar komune.

<sup>4</sup> Në 2014 (pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 2013) komunat Zvečan dhe Zubin Potok morën 4-4 ulëse shtesë si rezultat i vendimit të Qeverisë së Kosovës (për krahasim, shih Tabelën 3).

Tabela 3: Ulëset në Kuvende Komunale 2000-2014

Komuna	2000 <sup>5</sup>	2002	2007 <sup>6</sup>	2009 <sup>7</sup>	2013 <sup>8</sup>
1 - Deçan	31	31	31	27	27
2 - Gjakovë	41	41	41	41	35
3 - Glllogoc	31	31	31	31	31
4 - Gjilan	41	41	41	41	35
5 - Dragash	21	21	21	27	27
6 - Istog	31	31	31	27	27
7 - Kaçanik	31	31	31	27	27
8 - Klinë	31	31	31	27	27
9 - Fushë Kosovë	21	21	21	27	27
10 - Kamenicë	31	31	31	27	27
11 - Mitrovicë	41	41	41	41	35
12 - Leposavic <sup>5,6,7,8</sup>	17	17	17	19	19
13 - Lipjan	31	31	31	31	31
14 - Novobërdë <sup>6</sup>	17	17	17	15	15
15 - Obiliq	21	21	21	21	21
16 - Rahovec	31	31	31	31	31
17 - Pejë	41	41	41	41	35
18 - Podujevë	41	41	41	41	35
19 - Prishtinë	51	51	51	51	51

<sup>5</sup> Në vitin 2000 rezultatet për 51 ulëse nuk u certifikuan (në Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan)

<sup>6</sup> Në vitin 2007 lidhur me 85 ulëse nuk u certifikuan (në Leposaviq, Novobërdë, Shtërpçë, Zubin Potok dhe Zveçan)

<sup>7</sup> Në 2009 kuvendet komunale në Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan nuk u themeluan ndonëse rezultatet ishin certifikuar.

<sup>8</sup> Në vitin 2014 komuna e Zveçanit dhe e Zubin Potok-ut morën 4-4 ulëse shtesë (shih Tabela 3 fusnota 6).

20 - Prizren	41	41	41	41	41
21 - Skenderaj	31	31	31	31	31
22 - Shtime	21	21	21	21	21
23 - Shtërpçë <sup>6</sup>	17	17	17	19	15
24 - Suharekë	41	41	41	35	31
25 - Ferizaj	41	41	41	41	41
26 - Viti	31	31	31	27	27
27 - Vushtrri	31	31	31	35	35
28 - Zubin Potok <sup>5,6,7,8</sup>	17	17	17	19	19
29 - Zveçan <sup>5,6,7,8</sup>	17	17	17	19	19
30 - Malishevë	31	31	31	31	31
31 - Junik	-	-	-	15	15
32 - Mamusha	-	-	-	15	15
33 - Hani i Elezit	-	-	-	15	15
34 - Graçanica	-	-	-	19	19
35 - Ranillug	-	-	-	15	15
36 - Partesh	-	-	-	15	15
37 - Klllokot	-	-	-	15	15
38 - Mitrovicë e Veriut	-	-	-	-	19
<b>Gjithsej</b>	<b>920</b>	<b>920</b>	<b>920</b>	<b>1021</b>	<b>1,002</b>

Burimi: Arkivi i OSBE-së, KQZ

## KAPITULLI II - ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

### Përgatitje të procesit zgjedhor

Ky kapitull, ofron informata të hollësishme për administrimin e zgjedhjeve duke paraqitur të dhëna lidhur me afatet apo periudhat kohore të zgjedhjeve dhe numrin e Qendrave të Votimit dhe të Vendvotimeve (VV). Ndonëse sistemi zgjedhor në Kosovë kryesisht ka mbetur i njëjtë që nga viti 2000, kohëzgjatja e procesit zgjedhor (nga njoftimi e deri në certifikim të rezultateve) ka pasur dallime të mëdha (shih: tabela 4). Në kontekst, duhet theksuar se para vitit 2008, data e zgjedhjeve nuk ka qenë e fiksuar me rregulloren e zbatueshme të UNMIK-ut<sup>9</sup>, por ishte lënë në diskrecion të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP të OKB) (p.sh. në vitin 2000 data është caktuar gjatë regjistrimit të votuesve, në vitin 2002 data ishte shtyrë).

Sipas legjislacionit në fuqi<sup>10</sup>, data e zgjedhjeve caktohet nga nga Presidenti, jo më vonë se katër muaj dhe jo më shumë se gjashtë muaj para datës së zgjedhjeve. Rrjedhimisht, kohëzgjatja maksimale e procesit zgjedhor para datës së mbajtjes së zgjedhjeve është 6 muaj (shih gjithashtu, tabelat 22-23 në Pjesën II).

Nuk ka ndonjë afat specifik të vendosur për certifikimin e rezultateve.

Duke i pasur parasysh dispozitat e sipërpërmendura, kuptohet që, derisa kohëzgjatja totale e periudhës zgjedhore ishte 98 ditë në rastin e zgjedhjeve për Kuvend të Kosovës më 2007, për administrimin e zgjedhjeve për Kuvend të Kosovës në vitin 2001 u deshën 196 ditë (përfshirë zgjedhjet e parakohshme të Kuvendit të Kosovës për shkak të dispozitave speciale të ndërlidhura me to). Nuk mund të identifikohet një trend i qartë në këto shifra, përveç që nga viti 2007.

Periudhat nga dita e zgjedhjeve e deri në certifikimin e rezultateve janë shumëfishuar, që mund të shpjegohet me shfrytëzimin më të shpeshtë të

---

<sup>9</sup> Shih Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/39 për zgjedhjet komunale në Kosovë (neni 1); Rregullore e UNMIK nr. 2001/33 për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës (Pjesa 2); Rregullore e UNMIK-ut nr. 2002/11 për zgjedhjet komunale në Kosovë (Pjesa 2); Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/12 për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës (Pjesa 2) dhe Rregullore e UNMIK-u nr. 2007/26 që ndryshon Rregullore UNMIK nr. 2004/12 për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës (Pjesa 1.1).

<sup>10</sup> Ligji nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, e ndryshuar (LZP), neni 4.

mjeteve juridike në dispozicion si dhe cilësinë e performancës së Këshillave të Vendvotimeve.

Të dhënat statistikore (shih tabelën 5 dhe 6) tregojnë se si numri i Qendrave të Votimit dhe Vendvotimeve ka ndryshuar (është rritur) me kalimin e viteve. Brenda kufijve të legjislacionit dhe hapësirave në dispozicion, KQZ rishikon (kohë pas kohe), numrin dhe lokacionin e Qendrave të Votimit dhe Vendvotimeve. Sipas dispozitave ligjore, që nga viti 2000 numri i votuesve të caktuar në Vendvotime (me disa përjashtime) nuk mund të tejkalojë numrin 750, si rregull i përgjithshëm (në vitin 2000 ky numër ishte 700, ndërsa në vitin 2004 ishte 1000). Por, në rrethana të jashtëzakonshme, KQZ mund të shtojë numrin e votuesve në Vendvotim.

**Tabela 4: Periudha kohore ndërmjet shpalljes dhe certifikimit të rezultateve**

2014-Kuvend të Kosovës	57	31	26
2013-Komunale	162	124	38
2013-Kryetarë të komunave	162	124	38
2010- Kuvend të Kosovës	97	40	57
2009- Komunale	181	152	29
2009- Kryetarë të komunave	191	152	39
2007- Kuvend të Kosovës	98	80	18
2007- Komunale	111	80	31
2007- Kryetarë të komunave	111	80	31
2004- Kuvend të Kosovës	187	171	16
2002- Komunale	146	138	8
2001- Kuvend të Kosovës	196	187	9
2000- Komunale	123	112	11
<b>Kohëzgjatja totale (ditë)</b>			
<b>Kohëzgjatja ndërmjet shpalljeve &amp; Ditës së zgjedhjeve (ditë)</b>		<b>Certifikimi (ditë)</b>	

Burimi: Arkivi i OSBE-së, KQZ

Tabela 5: Numri i qendrave të votimit/vendvotimeve 2000-2007 sipas komunave<sup>11</sup>

Komuna	Kuvend Komunal 2000		Kuvend të Kosovës 2001		Kuvend Komunal 2002		Kuvend të Kosovës 2004		Kuvend komunal, kryetar të komunës dhe Kuvend të Kosovës 2007	
	QV	VV	QV	VV	QR	VV	QV	VV	QV	VV
1 - Deçan	6	32	6	40	7	43	9	43	9	56
2 - Gjakovë	15	84	15	86	20	94	21	95	23	122
3 - Gllogoc	12	43	12	46	12	48	13	43	15	63
4 - Gjilan	10	78	24	95	26	99	31	98	33	133
5 - Dragash	13	35	18	40	18	41	19	43	23	55
6 - Istog	9	36	9	41	10	42	11	42	10	53
7 - Kaçanik	11	41	11	44	11	45	13	38	16	53
8 - Klinë	8	33	8	35	10	37	12	40	11	50
9 - Fushë Kosovë	4	20	10	26	10	27	11	27	11	38
10 - Kamenicë	9	33	16	47	16	46	20	45	24	62
11 - Mitrovicë	16	72	17	85	19	85	21	88	28	118
12 - Leposaviq	3	3	8	19	13	24	16	25	17	31
13 - Lipjan	11	47	17	60	18	63	19	54	22	79
14 - Novobërdë	2	2	4	4	4	4	4	4	5	5

<sup>11</sup> Legjenda: QV: qendra të votimit, VV: vendvotime



15 - Obiliq	6	17	10	21	10	22	15	23	13	32
16 - Rahovec	16	47	20	54	20	56	23	56	28	74
17 - Pejë	14	84	15	87	15	88	17	97	19	124
18 - Podujevë	22	77	23	80	25	81	28	74	33	117
19 - Prishtinë	41	176	45	184	47	189	50	163	51	241
20 - Prizren	38	136	42	152	44	155	45	146	56	217
21 - Skenderaj	16	47	16	50	18	54	18	50	19	74
22 - Shtime	6	23	6	24	7	24	8	23	8	32
23 - Shtërpcë	2	4	7	13	9	15	9	14	9	22
24 - Suharekë	28	56	28	64	29	66	31	64	30	86
25 - Ferizaj	16	90	16	91	16	93	18	83	22	127
26 - Viti	11	44	16	48	18	50	20	50	22	73
27 - Vushtrri	16	60	18	65	21	68	22	64	21	90
28 - Zubin Potok	2	2	7	10	8	11	8	11	12	17
29 - Zveçan	1	1	5	10	5	10	6	11	6	16
30 - Malishevë	16	43	17	47	17	47	19	48	25	63
<b>TOTALI</b>	<b>380</b>	<b>1,466</b>	<b>466</b>	<b>1,668</b>	<b>503</b>	<b>1,727</b>	<b>557</b>	<b>1,662</b>	<b>621</b>	<b>2,323</b>

Burimi: Rezultatet e certifikuara të zgjedhjeve, Arkivi i OSBE

Tabela 6: Numri i qendrave të votimit/vendvotimeve 2009-2014 sipas komunave<sup>12</sup>

Komuna	Kuvend Komunal 2009		Kuvend të Kosovës 2010		Kuvend Komunal 2013		Kuvend të Kosovës 2014	
	QV	VV	QV	VV	QV	VV	QV	VV
1 - Deçan	8	49	8	49	8	50	8	50
2 - Gjakovë	28	129	28	129	28	134	28	134
3 - Gllogovc	20	59	20	59	24	66	24	66
4 - Gjilan	31	127	28	122	33	125	33	125
5 - Dragash	28	53	28	53	31	57	31	57
6 - Istog	15	55	15	55	15	58	15	58
7 - Kaçanik	16	42	16	42	19	46	19	46
8 - Klinë/Klina	16	51	16	53	17	55	17	55
9 - Fushë Kosovë	9	37	9	37	10	40	10	40
10 - Kamenicë	25	51	25	51	26	54	26	55
11 - Mitrovicë	32	123	32	126	28	97	28	97
12 - Leposaviq	17	30	17	30	18	31	18	31
13 - Lipjan	26	71	26	71	26	76	26	76
14 - Novobërdë	18	19	18	19	19	21	19	21
15 - Obiliq	14	31	14	32	14	33	14	33
16 - Rahovec	34	71	34	71	35	74	35	76
17 - Pejë	23	121	23	122	23	125	23	125
18 - Podujevë	43	104	43	107	43	109	43	109
19 - Prishtinë	56	216	56	220	56	218	56	218

<sup>12</sup> Legjenda: QV: qendra të votimit, VV: vend votime

20 - Prizren	60	198	60	204	67	208	67	211
21 - Skenderaj	32	70	32	70	32	72	32	72
22 - Shtime	10	32	10	32	11	33	11	33
23 - Shtërpçë	9	18	9	18	9	19	9	19
24 - Suharekë	30	79	30	80	32	85	32	85
25 - Ferizaj	25	122	25	122	32	126	32	128
26 - Viti	26	58	26	58	27	61	27	61
27 - Vushtrri	24	87	24	90	26	88	26	88
28 - Zubin Potok	12	15	12	15	12	16	12	16
29 - Zveçan	6	13	6	13	7	14	7	14
30 - Malishevë	29	65	29	65	35	71	35	71
31 - Junik	1	7	1	7	1	7	1	7
32 - Mamushë	1	4	1	4	1	4	1	4
33 - Hani i Elezit	4	12	4	12	4	11	4	11
34 - Graçanica	10	25	10	25	10	27	10	27
35 - Ranillug	3	7	3	7	4	8	4	8
36 - Partesh <sup>13</sup>	-	-	3	5	3	7	3	7
37 - Klllokot	5	5	5	5	5	7	5	7
38 - Mitrovicë e Veriut	-	-	-	-	7	33	7	33
<b>TOTALI</b>	<b>746</b>	<b>2,256</b>	<b>746</b>	<b>2,280</b>	<b>798</b>	<b>2,366</b>	<b>798</b>	<b>2,374</b>

Burimi: KQZ

<sup>13</sup> Numri i qendrave të votimit gjatë zgjedhjeve për kuvend komunal dhe kryetar komune të mbajtura më 20 qershor kanë qene 3 dhe 5 respektivisht.



## KAPITULLI III - REGJISTRIMI I VOTUESVE

### Regjistrimi i votuesve

Regjistrimi i votuesve, është pjesë e rëndësishme e procesit zgjedhor në Kosovë. Ky kapitull paraqet shifrat themelore për elektoratin. Në vitin 2000, ishte themeluar një Task Forcë e përbashkët e regjistrimit nga UNMIK-u dhe OSBE-ja për ta filluar regjistrimin e banorëve të përhershëm në tërë Kosovën. Kjo ka rezultuar me krijimin e Bazës Qendrore të të Dhënave, që e ka mundësuar krijimin e Listës së Votuesve për zgjedhjet e para që janë organizuar në vitin 2000, nga OSBE-ja.

Në fund të vitit 2000, janë themeluar qendrat komunale të regjistrimit civil (QKRC), dhe aplikacionet janë dërguar në Qendrën Kryesore të Procesimit ku të dhënat janë integruar në Bazën Qendrore të të Dhënave dhe janë prodhuar Letërnjoftimet e UNMIK-ut për aplikuesit e moshës madhore.

Në vitin 2001, është organizuar një fushatë e posaçme e regjistrimit për komunitetet jo shumicë: ekipet e regjistrimit i kanë regjistruar personat nga komunitetet jo shumicë dhe të njëjtëve iu kanë lëshuar letërnjoftime të UNMIK-ut. Që atëherë, të gjitha operacionet e regjistrimit civil, janë bërë nga QKRC-të.

Në vitin 2005, UNMIK-u i ka transferuar përgjegjësitë menaxheriale operacionale për aktivitete të regjistrimit tek QKRC-të dhe autoritetet në Qendrën Kryesore të Procesimit, ndërsa UNMIK-u ka mbajtur rolin e mbikëqyrjes dhe autoritetin përfundimtar mbi Bazën Qendrore të të Dhënave.

Pas shpalljes së pavarësisë, Institucionet e Republikës së Kosovës, kanë marrë përgjegjësitë mbi Regjistrin Civil. Agjencia e Regjistrimit Civil është themeluar në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në Kosovë, është përdorur “Sistem pasiv i regjistrimit të votuesve”, e ku lista e votuesve, është nxjerrë nga baza përkatëse e të dhënave (Regjistri Civil).

Kriteret për të drejtën e votimit të votuesve para vitit 2008, janë përcaktuar me Rregullore të UNMIK-ut, udhëzime administrative dhe rregulla të tjera, ndërsa që nga viti 2008 ato janë përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Para vitit 2008, e drejta e votimit ka qenë e ndërlidhur me vendbanimin (faktik apo të supozuar) brenda Kosovës, dhe që atëherë,

është ndërlidhur kryesisht me statusin e shtetësisë. Tabelat 7 dhe 8, paraqesin numrin e votuesve të regjistruar për secilën komunë nga viti 2000 deri 2014, siç është përcaktuar në rezultatet zyrtare të certifikuara. Duhet të theksojmë këtu se rezultatet zyrtare mes viteve 2000 dhe 2007, janë bërë duke përdorur qasje të ndryshme, gjë që e bënë të vështirë krahasimin e ndryshimeve me shifra:

- a) Në vitin 2000 dhe 2002 (në rastin e zgjedhjeve për kuvende komunale), rezultatet zyrtare i kanë llogaritur edhe votuesit që kanë marrë pjesë në programet e votimit jashtë Kosovës dhe votimit me nevoja të veçanta në ato komuna për të cilat ata kanë votuar. Por informatat për ato kategori të votuesve nuk janë dhënë ndaras.
- b) Në vitin 2001 (zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës), rezultatet zyrtare nuk i kishin llogaritur votuesit nga programet e votimit jashtë Kosovës (qoftë personalisht apo me postë) dhe votimit me nevoja të veçanta në cilëndo komunë, por informatat për këto kategori të votuesve janë dhënë ndaras.
- c) Në vitin 2004 (zgjedhjet për kuvend të Kosovës), rezultatet zyrtare i kanë ndarë vetëm votuesit nga programi i votimit jashtë Kosovës (si personalisht ashtu edhe me postë), derisa të dhënat për kategoritë tjera të programeve për votim me nevoja të veçanta janë inkorporuar në të dhënat komunale.
- d) Në vitin 2007, për sa u përket të gjitha llojeve të zgjedhjeve – ngjashëm si në vitin 2000 dhe 2002, votuesit që kanë marr pjesë në programet e veçanta të votimit nuk janë paraqitur ndarazi në rezultatet zyrtare.

Ndryshimet në të dhëna, deri në një masë, karakterizojnë edhe historinë e fundit të Kosovës: nga krijimi i disa komunave të reja në vitin 2009, te vështirësitë në caktimin e saktë të votuesve, për shkak të krijimit të komunave të reja, të cilat janë shkëputur nga komunat amë. Për sa u përket komunave të reja, ja disa informacione:

- Juniku, është krijuar nga territori i komunës së Deçanit.
- Parteshi, është krijuar nga territori i komunës së Gjilanit.
- Hani i Elezit, është krijuar nga territori i komunës së Kaçanikut.
- Mamusha, është krijuar nga territori i komunës së Prizrenit ( Urdhëresa Administrative nr. 2005/11). Zgjedhjet në këtë komunë, nuk janë mbajtur

deri në vitin 2009, ndërsa në komunën e Parteshit, zgjedhjet janë mbajtur në vitin 2010.

- Graçanicë, është krijuar nga territori i komunës së Prishtinës (Udhëzimi Administrativ nr. 2005/11). Kësaj komune, i janë bashkëngjitur disa fshatra nga komuna e Lipjanit dhe e Fushë Kosovës përmes Ligjit nr. 03/L-041/2008 për Kufijtë Administrativë Komunalë. Zgjedhjet në këtë komunë të re, nuk janë mbajtur deri në vitin 2009.
- Klllokoti, është krijuar nga territori i komunës së Vitisë.
- Ranillugu, është krijuar nga territori i komunës së Kamenicës.
- Mitrovica e Veriut, është krijuar duke e ndarë komunën e mëparshme unike të Mitrovicës përmes Ligjit nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativë Komunalë në vitin 2008.

Rritja e konsiderueshme në numrin e votuesve (me rreth 72%) ndërmjet vitit 2000 dhe 2007 mund të sqarohet, pjesërisht, me rrethanat e regjistrimit të votuesve (p.sh. bojkotimin e zgjedhjeve nga serbët në vitin 2000 – shih të dhënat e veçanta për komunat si Leposaviqi, Novobërda, Shtërpca, Zubin Potoku dhe Zveçani). Kjo rritje është ngadalësuar ndërmjet viteve 2009 dhe 2014 (numri i votuesve me të drejtë vote është rritur me vetëm rreth 14%), dhe ka qenë mjaft stagnues në dy zgjedhjet e fundit. Analiza e detajuar e rritjes nuk është objekt i këtij publikimi, por arsyeja kryesore – përveç atyre të përmendura më lart – është ulja e supozuar e votuesve në listën e votuesve dhe fakti që adresat janë regjistruar në mënyrë të pasaktë apo nuk janë në përputhje me regjistrin civil.

Tabela 7: Votuesit – Elektorati sipas komunave 2000-2007<sup>14</sup>

KOMUNA (sipas numërimit që përdoret nga KQZ)	KOMUNALE 2000	KUVEND TË KOSOVËS 2001	KOMUNALE 2002	KUVEND TË KOSOVËS 2004	KUVEND KOMUNAL, KRYETAR KOMUNE & KUVEND TË KOSOVËS 2007
1 - Deçan	21,738	26,613	31,725	33,451	38,806
2 - Gjakovë	55,529	61,533	72,641	74,759	86,953
3 - Glogoc	26,857	30,789	33,941	36,082	41,492
4 - Gjilan	52,413	65,355	79,075	77,506	93,463
5 - Dragash	20,166	24,388	29,233	30,322	34,964
6 - Istog	22,899	26,447	35,247	31,672	40,979
7 - Kaçanik	24,905	27,920	30,337	31,948	34,830
8 - Klinë	20,964	24,670	31,915	28,869	38,098
9 - Fushë Kosovë	12,420	16,652	24,081	20,444	29,729
10 - Kamenicë	21,829	29,805	38,073	35,602	43,316
11 - Mitrovicë	44,802	56,395	65,207	67,486	81,943
12 - Leposaviq	347	11,244	13,607	14,108	17,029
13 - Lipjan	29,070	37,916	43,786	43,336	52,561
14 - Novobërdë	918	1,886	2,769	2,462	3,506
15 - Obiliq	9,737	12,639	17,569	15,740	21,531
16 - Rahovec	28,197	34,593	39,313	39,696	46,008
17 - Pejë	54,601	60,862	79,328	73,247	94,512
18 - Podujevë	46,915	53,717	60,362	62,415	70,660
19 - Prishtinë	110,400	125,053	155,234	139,587	176,097
20 - Prizren	85,371	100,184	117,347	115,805	141,299
21 - Skenderaj	27,707	32,386	36,923	39,209	44,953
22 - Shtime	13,785	14,048	17,426	17,838	20,482
23 - Shtërpçë	1,837	8,349	10,179	10,202	12,120
24 - Suharekë	32,666	40,011	45,681	46,000	53,751
25 - Ferizaj	57,724	63,867	76,350	74,174	89,741
26 - Viti	27,462	31,460	38,085	37,822	44,407
27 - Vushtrri	36,291	42,788	49,264	50,614	58,856
28 - Zubin Potok	496	4,653	5,845	6,127	7,713
29 - Zveçan	26	6,354	7,245	7,089	8,628
30 - Malishevë	25,107	29,959	32,693	34,363	39,263
Kategoritë e veçanta	N/Z	147,451 <sup>15</sup>	N/Z	114,705 <sup>16</sup>	N/Z
<b>TOTALI</b>	<b>913,179</b>	<b>1,249,987</b>	<b>1,320,481</b>	<b>1,412,680</b>	<b>1,567,690</b>

Burimi: Rezultatet zyrtare të certifikuara 2000-2007 (Arkivi i OSBE-së)

<sup>14</sup> Shih sqarimet në këtë tabelë më lartë.

<sup>15</sup> Nga 147,451 votues 98,830 kanë votuar në Serbi dhe 6,329 në mal të zi (votim me pjesëmarrje fizike), derisa gjithsej 42,292 kanë votuar me postë në kuadër të programit të votimit me nevoja të veçanta.

<sup>16</sup> Nga 114,705 votues 108,746 kanë votuar në Serbi dhe Mal të zi (votim me pjesëmarrje fizike) dhe 5,959 me postë.



Tabela 8: Votues – Elektorati sipas komunave 2009–2014

KOMUNA (sipas numërimit që përdoret nga KQZ)	KOMUNALE & KRYETAR KOMUNE 2009	KUVEND TË KOSOVËS 2010	KOMUNALE & KRYETAR KOMUNE 2013	KUVEND TË KOSOVËS 2014
1 - Deçan	35,727	37,244	40,056	40,212
2 - Gjakovë	91,866	97,215	107,425	107,844
3 - Gllogoc	44,713	46,657	50,067	50,231
4 - Gjilan	87,430	87,387	94,268	94,425
5 - Dragash	35,454	36,658	39,233	39,172
6 - Istog	38,533	40,778	45,569	45,905
7 - Kaçanik	29,397	30,308	32,291	32,373
8 - Klinë	36,576	38,705	43,691	44,270
9 - Fushë Kosovë	26,154	28,105	31,686	32,085
10 - Kamenicë	34,540	35,381	37,376	37,428
11 - Mitrovicë	83,307	86,834	72,560	72,764
12 - Leposaviq	16,550	16,730	19,513	18,268
13 - Lipjan	48,084	50,374	55,129	55,555
14 - Novobërdë	7,938	7,936	9,133	9,243
15 - Obiliq	20,204	21,313	23,157	23,224
16 - Rahovec	47,400	49,321	53,815	53,936
17 - Pejë	89,156	93,721	103,078	103,490
18 - Podujevë	72,968	75,637	80,676	80,526
19 - Prishtinë	154,935	161,236	172,143	172,289
20 - Prizren	137,849	144,578	156,427	156,970
21 - Skenderaj	47,598	49,320	52,555	52,641
22 - Shtime	21,530	22,313	24,444	24,511
23 - Shtërpçë	12,260	12,604	13,818	13,834

24 - Suharekë	55,532	57,617	61,857	62,230
25 - Ferizaj	88,306	91,876	100,245	100,675
26 - Viti	41,438	42,881	46,246	46,348
27 - Vushtrri	60,762	63,300	68,074	68,210
28 - Zubin Potok	7,482	7,563	8,948	8,021
29 - Zveçan	8,409	8,475	9,986	9,676
30 - Malishevë	42,318	44,089	48,047	48,430
31 - Junik	4,962	5,191	5,526	5,546
32 - Mamushë	2,835	3,112	3,541	3,642
33 - Hani i Elezit	7,683	7,943	8,501	8,554
34 - Graçanica	16,317	16,825	19,200	19,623
35 - Ranillug	4,822	4,929	5,532	5,649
36 - Partesh	N/Z	3,695	4,332	4,426
37 - Klllokot	2,706	2,785	3,297	3,396
38 - Mitrovica e Veriut	N/Z	N/Z	27,915	26,832
<b>TOTALI</b>	<b>1,563,741</b>	<b>1,630,636</b>	<b>1,779,357</b>	<b>1,782,454</b>

Burimi: KQZ

## KAPITULLI IV - REGJISTRIMI I PARTIVE POLITIKE, CERTIFIKIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE DHE KANDIDATËVE

### Të dhëna për partitë politike

Ky kapitull përmban informata themelore për ndryshimin kalimtar të krijimit dhe shuarjes së partive politike dhe ndërlidhjet e tyre etnike, si dhe seritë kohore për certifikimin e subjekteve politike që garojnë në zgjedhje.

Partitë politike kanë rol thelbësor në shoqëritë demokratike, meqë funksioni i tyre kryesor, është pjesëmarrja në zgjedhje për ta fituar pushtetin, apo së paku, ndikimin politik, dhe për të pasur përfaqësuesit e tyre në organet qeverisëse për të realizuar programet dhe politikat e tyre. Është e nevojshme të theksohet dallimi ndërmjet regjistrimit të partive politike dhe certifikimit të tyre për zgjedhje.

Regjistrimi i partive politike, është mënyra se si një organizatë e individëve që dëshirojnë të trajtohen si parti politike fiton subjektivitetin juridik. Kjo nuk ndërlidhet me zgjedhje specifike, por mund të ndodhë në çdo kohë ndërmjet zgjedhjeve. Mirëpo, regjistrimi është parakusht që një parti politike të certifikohet. Në anën tjetër, certifikimi i subjekteve politike është pjesë e procesit zgjedhor në kuptim më të ngushtë, dhe qëllimi i tij është që të qartësojë nëse një subjekt i caktuar politik ka të drejtë për të garuar në zgjedhje. Jo vetëm partitë politike, por edhe koalicionet e prej dy apo më shumë partive politike të regjistruara, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur i nënshtrohen certifikimit.

Ndërmjet vitit 2000 dhe 2008, regjistrimi i partive politike ka qenë detyrë e administratës së UNMIK-ut, pra Administratës Civile (Shtyllës II nga viti 2000 deri 2004) dhe OSBE-së (Shtylla III nga viti 2004 në vitin 2008). Që nga viti 2008 me hyrjen në fuqi të Ligjit nr 03/L-073, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ajo është një nga detyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Si UNMIK-u ashtu edhe KQZ-ja kanë vepruar si autoritete rregullative dhe mbikëqyrëse për sa i përket partive politike. Para vitit 2008, regjistrimi i partive politike dhe certifikimi i tyre për zgjedhje kanë qenë procese të ndara, dhe që atëherë ky proces ka qenë në duart e të njëjtit autoritet: KQZ-ja ka autoritet si për regjistrimin ashtu edhe për certifikimin e partive politike.

Deri më 14 tetor 2014 në KQZ kanë qenë të regjistruara 63 parti politike. Tabela 9 tregon sa parti politike janë regjistruar apo ç'regjistruar/shkrirë brenda një viti që nga viti 2000. Tabela 10 përmban të dhëna për sa i përket numrit të subjekteve politike të certifikuara, etnisë së tyre dhe numrit të përgjithshëm të kandidatëve të certifikuar për secilën zgjedhje (të ndara në bazë të gjinisë).

Tabela 9: Partitë politike të regjistruara dhe të çregjistruara

	2000 <sup>17</sup>	2001 <sup>17</sup>	2002 <sup>17</sup>	2003 <sup>18</sup>	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Total
Të regjistruara	17 <sup>19</sup>	4	6	0	3	1	5	7	1	5	14	0	4	8	9	84
Të çregjistruara										6	0	7	0	1	3	17
Të shkruara											1	1				2

Burimi: KQZ

<sup>17</sup> Numri i partive politike të regjistruara në vitin përkatës dhe kanë qenë funksionale në fund të vitit 2003. (Gjatë viteve 2000 deri 2003, nuk ka të dhëna në lidhje me çregjistrimin.)

<sup>18</sup> Sipas Raportit të OSBE-së për Raportet vjetore të partive politike për vitin 2002 dhe 2003 (maj 2004) në atë kohë janë regjistruar 27 parti politike (<http://www.osce.org/node/33450>).

<sup>19</sup> Sipas Raportit të Sekretarit të Përgjithshëm për Këshillin e Sigurimit për Misionin e Administrimit të Përkohshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (S/2000/538 – 6 qershor 2000) “diku 30” parti politike shqiptare, 3 boshnjake dhe 2 turke kanë qenë aktive në vitin 2000, por vetëm 28 parti politike kanë aplikuar për certifikim në KQZ, përfshirë një parti politike serbe (shih raportin nr. 10 dhe 11 për takimet e Komisionit Qendror Zgjedhor në vitin 2000 (arkiva e OSBE-së)).

Tabela 10: Certifikimi i Subjekteve Politike

		2000 KOMUNALE	2001 KUVEND	2002 KOMUNALE	2004 KUVEND	2007 KUVEND KOMUNALE KRYETAR KOMUNE	2009 KOMUNAL KRYETAR KOMUNE	2010 KUVEND	2013 KOMUNAL E KRYETAR KOMUNE	2014 KUVEND
1.	Parti	19	19	28	22	25	37	24	33	18
2.	Koalicione	2	2	1	1	2	2	2	2	4
3.	Iniciativa Qytetare	3	2	28	5	36	19	3	52	7
4.	Kandidatë të pavarur	15	3	11	5	33	16	0	16	1
5.	Numri i përgjithshëm i subjekteve	39	26	68	33	96	74	29	103	30
6	Etnia - Vetëdeklaruar									
	*Shqiptar	29	19	25	21	51	34	7	50	9
	*Serb	—	1	30	2	33	22	9	31	5
	*Boshnjak, Goran	4	2	6	5	6	7	6	10	8
	*Rom, Ashkali, Egjiptian	4	3	5	4	3	5	5	5	6
	*Turq	2	1	1	1	3	4	2	3	2
	*Malazez	—	—	—	—	—	2	0 <sup>20</sup>	3	-
	*Kroat	—	—	1	—	—	—	—	1	—
7.	Kandidat									
	Burra	4,119	959	3,985	934	5,458	4,598	839	5,284	833
	Gra	1,322	374	1,487	381	2,465	2,191	427	2,642	402
	Numri i përgjithshëm i kandidatëve	5,441	1,333	5,472	1,315	7,923	6,789	1,266	7,926	1,235

Burimi: Arkiva e OSBE-së, KQZ

<sup>20</sup> Crnkagorska Demokratska Stranka (CDS) ka garuar për ulëset e rezervuara për pakicën serbe.

## KAPITULLI V - AKREDITIMI I VËZHguesVE

### Të dhëna mbi procesin e vëzhgimit të zgjedhjeve

Ky kapitull, përmban të dhëna themelore për numrin e vëzhguesve të akredituar për lloje të ndryshme organizatave nominuese.

*“Vëzhgimi i zgjedhjeve është mjet i vlefshëm për përmirësimin e cilësisë së zgjedhjeve. Vëzhguesit ndihmojnë në ndërtimin e besimit të publikut në lidhje me ndershmërinë e proceseve zgjedhore. Vëzhgimi mund të ndihmojë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave civile dhe politike të pjesëmarrësve në zgjedhje. Ai mund të shpie në korrigjim të gabimeve apo praktikave jo të mira, edhe në rastet kur një proces i zgjedhjeve është në vazhdim e sipër. Mund ta parandalojë manipulimin dhe mashtrimin, apo të ekspozojë probleme të tilla nëse ato paraqiten. Kur vëzhguesit publikojnë raporte pozitive, rritet besimi në proceset demokratike dhe përmirësohet legjitimiteti i qeverive që dalin nga zgjedhjet. Vëzhgimi i zgjedhjeve nga grupet vendore inkurajon përfshirjen civile në proceset politike. Pas zgjedhjeve, raportet dhe rekomandimet nga grupet e vëzhguesve mund të çojnë në ndryshime dhe përmirësime në të drejtën dhe praktikën në vend.”<sup>21</sup>*

Duke i ditur shifrat për sa i përket numrit të vëzhguesve (shih: tabela 11), zgjedhjet në Kosovë kanë qenë lartë në listën e interesimit edhe për bashkësisë ndërkombëtare edhe akterët vendorë: që nga viti 2000 numri i vëzhguesve vendorë është gjashtëfishuar, ku numri i vëzhguesve të subjekteve politike është rritur edhe më shumë ose është shtatëfishuar.

Misionet ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve, kryesisht, përfshijnë misione të vëzhgimit nga Këshilli i Evropës (nga viti 2000 deri 2007), Rrjeti Evropian i Organizatave të Monitorimit të Zgjedhjeve (ENEMO – ndërmjet viteve 2009 dhe 2013), dhe Misionet e BE-së për monitorimin e zgjedhjeve (në vitin 2013 dhe 2014, derisa në vitin 2009 dhe 2010 BE-ja ka dërguar një mision teknik të ekspertëve me mandat të kufizuar). Vëzhguesit e tjerë ndërkombëtar kanë ardhur nga ambasadat, zyrat ndërlidhëse, Zyra e BE- së në Kosovë, Zyra Civile Ndërkombëtare, OJQ-të ndërkombëtare, si: Instituti Kombëtar Nacional Demokratik – NDI, Fondacioni Ndërkombëtar për Sistem Zgjedhor – IFES, Grupi Ndërkombëtar i Krizave. (Tabela 11 më poshtë nuk i përmban shifrat për sa i përket zgjedhjeve komunale dhe zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetarë të komunave të mbajtura ndërmjet viteve 2010 dhe 2012.)

<sup>21</sup> <http://www.un.org/womenwatch/osagi/wps/publication/Chapter7.htm>

Tabela 11: Akreditimi i Vëzhguesve

Nominimi i subjekteve	KOMUNALE 2000	KUVEND TË KOSOVËS 2001	KOMUNALE 2002	KUVEND TË KOSOVËS 2004	KUVEND TË KOSOVËS, KOMUNALE & KRYETAR TË KOM 2007	KUVEND TË KOSOVËS 2009	KUVEND TË KOSOVËS 2010	KUVEND TË KOSOVËS 2013	KUVE. TË KOSO. 2014
1. Subjektet Politike	4,541	8,993	8,531	10,671	24,453	20,243	26,049	26,985	31,692
2. OJQ-të vendore	1,346	4,303	3,946	1,986	2,640	2,560	5,301	2,724	3,938
3. Misionet Ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve	162	217	131	127	263	256	254	254	197
4. Vëzhguesit tjerë ndërkombëtar	0	0	0	122	104	444	535	210	194
6. Numri total i vëzhguesve	6,049	13,513	12,608	12,906	27,460	23,503	32,139	30,173	36,043
7. Numri total i vendotimeve	1,466	1,688	1,727	1662	2,323	2,256	2,280	2,366	2,374
8. Numri mesatar i vëzhguesve për vendotim	4	8	7	8	12	10	14	13	15
9. Numri mesatar i vëzhguesve të subjekteve politike për vendotim	3	5	5	6	11	9	11	11	13

Burimi: Arkiva e OSBE-së, KQZ



## KAPITULLI VI - VOTIMI, NUMËRIMI DHE REZULTATET

### Procesi i votimit

Ky kapitull përmban informata mbi llojin e procedurave të votimit, të dhëna themelore në lidhje me votimin dhe numërimin (pa rezultatet përfundimtare për subjekte politike për zgjedhje), si dhe për përbërjen gjinore dhe etnike të deputetëve të Kuvendit të Kosovës që prej vitit 2001.

Sistemi zgjedhor i Kosovës, i krijuar më 2000, pasqyronte prioritetet e nevojshme të mjedisit menjëherë pas konfliktit. Programet e votimit (shih: tabela 12) janë dizajnuar në përputhje me këto rrethana, si dhe për të përkrahur, posaçërisht të drejtën e pjesëmarrjes, të drejtën universale dhe të barabartë të votimit, si dhe mosdiskriminimit.

Në ciklet vijuese zgjedhore, prioritetet strukturore kanë ndërruar në përballje me sfida të reja, derisa programet e votimit kanë evoluar në përputhje me to.

Votimi i rregullt në Kosovë, obligon votuesin që të jetë i regjistruar në Regjistrin Civil dhe të jetë 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve, derisa emri i votuesit duhet të paraqitet në Listën e Votuesve të vendvotimit të tij.

Votimi bëhet në mënyrë të fshehtë. Gjithashtu, votuesi i cili është me aftësi të kufizuar në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, ose është abnalfabet mund të ndihmohet nga një person tjetër i zgjedhur nga votuesit nëse ai kërkon një ndihmë të tillë.

Komisioni Qendror Zgjedhor, u ofron mundësinë gjithashtu, të gjithë votuesve të verbër dhe me të pamun të dobësuar që të votojnë personalisht përmes shablloneve në alfabetin e Brajlit.

Votuesit, nuk mund ta autorizojnë dikë tjetër që të votojë në emrin e tyre.

Votimi me kusht në Kosovë, është mundësi e sistemit zgjedhor të pasluftës, që është përdorur për të avancuar pjesëmarrjen e votuesve me të drejtë votimi si dhe për të lehtësuar të drejtën e votës. Votuesit mund të votojnë brenda vendvotimit në vendbanimin e tyre, edhe nëse emrat e tyre mungojnë në listën e votuesve. Megjithatë, vota e tyre numërohet vetëm nëse e drejta e tyre e votimit mund të vërtetohet më vonë.

Sipas programit të Votimit për personat me nevoja dhe rrethana të veçanta, grupet e caktuara mund të regjistrohen të votojnë përmes ekipeve mobile të

votimit, pa pasur nevojë të shkojnë në vendvotime. Grupet e tilla, përfshijnë votuesit me të drejtë vote të cilët nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në vendvotimin e zakonshëm për shkak paaftësisë fizike, mjekësore ose çfarë do paaftësie tjetër, votuesit me të drejtë vote me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion, siç janë votuesit në hospitalizim, njerëzit e moshuar në shtëpitë e caktuar veçanërisht për të moshuarit, personat me aftësi të zvogëluar mendore në institucionet e kujdesit shëndetësorë dhe të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendra të paraburgimit dhe votuesit me rrethana të vecant, që përbëjnë votuesit që jetojnë në bashkësitë, të cilat për shkak të zhvendosjes nga vendi afër vendvotimit të tyre të rregullt ose për shkaqe sigurie nuk mund të votojnë në vendvotimin e tyre të caktuar.

Deri më 2004, mundësohej votimi personalisht, duke përfshirë votimin me asistim, për votuesit me të drejtë votimi në vende jashtë Kosovës. Që prej vitit 2000, votimi përmes postës ka qenë pjesë e të gjitha zgjedhjeve. Ky program kërkon aplikim paraprak aktiv nga votuesit, si dhe pas vërtetimit të së drejtës së votimit, krijimin e listave të posaçme të votuesve. (Tabelat 13 dhe 14, përmbledhin të dhënat themelore të zgjedhjeve, pra, numrin e votuesve të regjistruar për zgjedhje (elektorati), përqindjen e daljes, fletëvotimet e hedhura, si dhe ndarjet e brendshme (fletëvotimet e vlefshme, fletëvotimet e pavlefshme, të paplotësuara), si dhe numrin e fletëvotimeve me kusht dhe ndarjen e tyre të brendshme – të miratuara/refuzuara).

Për shkak të ndarjeve të ndryshme të rezultateve në periudhën prej 2000 deri më 2014, tabelat dizajnohen sipas metodës së përdorur në zgjedhjet e caktuara.

Nga viti 2000 deri më 2007 (Tabela 13):

- Shkalla e daljes, është koeficienti i “Fletëvotimeve të hedhura” (rreshti 3) si dhe “Elektoratit” (rreshti 1);
- Rreshti i “Fletëvotimeve të hedhura” (rreshti 3) përfshin fletëvotimet me kusht dhe ato jashtë Kosovës, pra shuma e fletëvotimeve të vlefshme (rreshti 4), fletëvotimeve të pavlefshme (rreshti 5) si dhe atyre të zbrazëta (rreshti 6) jep totalin e fletëvotimeve të përdorura;

Nga viti 2009, deri më 2014 (Tabela 14)

- Numri i votuesve që paraqiten në vendvotim (2.1) si dhe që kanë votuar me forma të tjera të votimit (2.2.), paraqiten në rezultatet zyrtare.
- Shkalla e daljes në zgjedhje, është koeficienti i numrit të përgjithshëm të rreshtave 2.1 dhe 2.2, si dhe “Elektorati” (rreshti 1).
- KQZ-ja ka aplikuar një nivel minimal të tolerancës së pranueshme në lidhje me dallimet në rezultatet e vendvotimeve, që nënkupton se nganjëherë ekuacionet bazë (si p.sh. rreshti 2.1 dhe rreshti 2.2 duhet të jenë baras me rreshtin 4, ose rreshti 5 dhe rreshti 6 dhe rreshti 7 duhet të jenë të barabartë edhe me rreshtin 4) nuk përputhen.
- Më 2010, rezultatet e certifikuara dallonin ndërmjet rezultateve të votave të rregullta (të hedhura në vendvotimet e rregullta) si dhe rezultateve të votimit me kusht, pra vetëm më 2010, shifra në rreshtin 4 është e barabartë me shumën e shifrave në rreshtat 5-8.

Më 2000, rezultatet e kuvendeve komunale në komunat Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok nuk ishin certifikuar. Më 2007, rezultatet e kuvendeve komunale në Novobërdë, Leposav, Zubin Potok, Zveçan, Shtërpçë nuk ishin certifikuar. Tutje, as rezultatet për kryetar komune në Novobërdë, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Shtërpçë nuk ishin certifikuar.

Tabelat 15-19 paraqesin përbërjen gjinore dhe etnike të Kuvendit të Kosovës që prej vitit 2001. Edhe pse kuota gjinore prej 30% për rezultate ka qenë në fuqi që nga viti 2001 e tutje për zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës, ky raport është nxjerrë vetëm më 2007, 2010 dhe 2014.

Tabela 12: Programet e votimit

		KOMUNALE 2000	KUVENDI I KOSOVËS 2001	KOMUNALE 2002	KUVENDI I KOSOVËS 2004	KUVENDI I KOSOVËS, KOMUNALE DHE KRYETARËT E KOMUNAVE 2007	KOMUNALE & KRYETARËT 2009	KUVENDI I KOSOVËS 2010	KOMUNALE & KRYETARËT 2013	KUVENDI I KOSOVËS 2014
Në Kosovë	Rregullt	Përcaktuar Në mungesë Hershëm Palëvizshëm (aftësi e kufizuar)	Përcaktuar - Hershëm Palëvizshëm (aftësi e kufizuar)	Përcaktuar Në mungesë Hershëm Palëvizshëm (aftësi e kufizuar)	Përcaktuar - - Palëvizshëm (aftësi e kufizuar)	Përcaktuar - - Palëvizshëm (aftësi e kufizuar)	Përcaktuar - - -	Përcaktuar - - -	Përcaktuar - - -	Përcaktuar - - -
	Me kusht	Papërcaktuar	Papërcaktuar	Papërcaktuar	Papërcaktuar	Papërcaktuar	Papërcaktuar	Papërcaktuar	Papërcaktuar	Papërcaktuar
	Votimi me rrethana të posaçme	- Palëvizshëm (komunitete) Institucionet	- Palëvizshëm (komunitete) Institucionet	- Palëvizshëm (komunitete) Institucionet	- Palëvizshëm (komunitete) Institucionet	- Palëvizshëm (komunitete) Institucionet	- Palëvizshëm (komunitete) Institucionet	Palëvizshëm (komunitete) Palëvizshëm (komunitete) Institucionet	Palëvizshëm (komunitete) Palëvizshëm (komunitete) Institucionet	Palëvizshëm (komunitete) Palëvizshëm (komunitete) Institucionet
Jashtë Kosovës	Rregullt	Personalisht Me postë	Personalisht Me postë	Personalisht Me postë	Personalisht Me postë	- Me postë	- Me postë	- Me postë	- Me postë	- Me postë

Burimi: Dispozitat ligjore në fuqi (2000-2014)

Tabela 13: Përmbledhje e daljes në zgjedhje, ndarjeve të fletëvotimeve, si dhe komunave të certifikuara (2000-2007)

	KOMUNALE 2000	KUVENDI I KOSOVËS 2001	KOMUNALE 2002	KUVENDI I KOSOVËS 2004	KUVENDI I KOSOVËS 2007	KOMUNALE 2007	KRYETARË 2007	KRYETARË Raundi i dytë 08 dhjetor 2007
1. Elektorati	913,179	1,249,987	1,320,481	1,412,680	1,567,690	1,567,690	1,567,690	1,432,249
2. Dalja në zgjedhje	79,00%	64,30%	53,86%	49,52%	40,09%	39,44%	39,07%	29,37%
3. Fletëvotime të hedhura (= 4. + 5. + 6.)	721,260	803,796	711,205	699,519	628,630	618,230	612,513	420,660
4. Fletëvotime të vlefshme	687,332 <sup>22</sup>	788,303	699,399	690,089	571,767	565,919	589,050	414,025
5. Fletëvotime të pavlefshme	24,171	11,975	8,620	6,704	34,883	29,102	12,699	4,118
6. Fletëvotime të zbrazëta	9,757	3,518	3,186	2,726	21,980	23,209	10,764	2,513
7. Fletëvotime me kusht (nga gjithsej fletëvotime të hedhura)	41,967	57,969	34,898	39,814	33,791	- <sup>23</sup>	- <sup>23</sup>	20,317
Prej të cilave 7.1. të miratuara	36,641	44,359	23,555	29,971	26,791			N/Z
7.2. të refuzuara	5,326	13,610	11,343	9,843	7,000			N/Z

<sup>22</sup> Më 2000, si "vota të numëruara" në rezultatet e certifikuara.

<sup>23</sup> Në rastin e zgjedhjeve për Kuvend Komune dhe kryetarë komunash, rezultatet e certifikuara nuk përmendnin fletëvotimet me kusht.

8. Rezultate të pacertifikuara në # të komunave <sup>24</sup>	3	N/Z	0	N/Z	N/Z	5	4	
9 Numri i ulëseve të pacertifikuara <sup>26</sup>	51	N/Z		N/Z	N/Z	85	4	

*Burimi: Rezultatet e certifikuar (Arkivi i OSBE-së në Kosovë)*

<sup>24</sup> Më 2000, rezultatet e zgjedhjeve për kuvend komune në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok nuk ishin certifikuar, gjë që ndikonte në gjithsej 51 ulëse (5.6% nga 920 ulëse). Më 2007, rezultatet e zgjedhjeve komunale në Novobërdë, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Shtërpçë nuk ishin certifikuar, gjë që preku gjithsej 85 ulëse (9.2% të 920 ulëseve). Për më tepër, rezultatet e zgjedhjeve për kryetar komune Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Shtërpçë nuk ishin certifikuar. Në rastet e përmendura, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP i KB) kishte emëruar përfaqësuesit.

Tabela 14: Përmbledhje e daljes në zgjedhje, ndarjeve të fletëvotimeve dhe komunave të certifikuar (2009-2014)<sup>25</sup>

	KOMUNAL E 2009	KRYETARË 2009	KRYETARË Raundi i dytë 2009	KUVENDI I KOSOVËS 2010	KOMUNALE 2013	KRYETARË 2013	KRYETARË Raundi i dytë 2013	KUVENDI I KOSOVËS 2014
1. Elektorati	1,563,741	1,563,741	993,791	1,632,276	1,792,913	1,792,913	1,383,198	1,799,023
2.1. Numri i votuesve që votojnë në VV	675,098	675,057	376,895	706,317	811,489	807,240	539,038	734,055
2.2. Numri i votave me kusht, VNV apo JK	23,377	23,399	5,744	33,001	18,882	23,592	12,270	32,779
3. Dalja në zgjedhje	44,7%	44,67%	38,50%	45,29%	46,31%	46,34%	39,86%	42,63%
4. Fletëvotime të hedhura (= 5. + 6. + 7.) <sup>26</sup>	698,073	698,671	381,604	739,439 <sup>27</sup>	830,325	825,792	539,038	766,847
5. Fletëvotime të vlefshme	631,000	681,531	377,602	698,751	746,729	801,792	541,163	731,248
6. Fletëvotime të pavlefshme	54,084	10,990	3745	29,226	70,782	15,512	7,144	30,725
7. Fletëvotime të zbrazëta	12,751	4,923	257	4,780	12,775	8,248	288	4,842

<sup>25</sup> Shih shpjegimet më lart për këtë tabelë.

<sup>26</sup> Mospërputhjet e lejuara me legjislacion.

<sup>27</sup> Më 2010 numri i fletëvotimeve të dëmtuara gjithashtu është numëruar në këtë rresht. Për të pasur të dhëna të harmonizuara me ato të viteve paraprake, numri i fletëvotimeve të parregullta (1236) është nxjerrë nga shifra e publikuar në rezultatet e certifikuar.

8. Me kusht, me nevoja të veçanta dhe jashtë Kosovës <sup>28</sup>	30,147	30,503	6,757	33,001	23,543	23,592	12,554	34,723
Prej të cilave 8.1. miratuara	23,377	23,339	3,905	26,321	18,690	18,897	8,075	32,779
8.2. refuzuara	6,998	7,150	2,852	6,680	4,853	5,953	4,479	1,944
9. Rezultatet që nuk janë certifikuar në # të komunave <sup>29</sup>	3	3		N/Z	0	0	0	N/Z
10. Numri i ulëseve të pacertifikuara <sup>29</sup>	57	3		0	0	0	0	0

Burimi: KQZ

<sup>28</sup> Me përjashtim të vitit 2010, numri i fletëvotimeve me kusht, me nevoja të veçanta dhe jashtë Kosovës është i përfshirë brenda numrit të fletëvotimeve të hedhura.

<sup>29</sup> Më 2009, rezultatet e zgjedhjeve për kuvend komune dhe për kryetar komune në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan nuk ishin certifikuar.





36 - Partesh	-	-	-	-	-	-	-	-
37 - Kllokoti	-	-	-	-	-	-	-	-
38 - Mitrovicë e Veriut	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>GJITHSEJ</b>	<b>120</b>	<b>88</b>	<b>32</b>	<b>87</b>	<b>22</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>3</b>

Burimi: Arkivi i OMIK-ut, KOZ



36 - Partesh	-	-	-	-	-	-	-	-
37 - Kllokoti	-	-	-	-	-	-	-	-
38 - Mitrovicë e Veriut	-	-	-	-	-	-	-	-
GJITHSEJ	120	85	35	98	10	5	4	3

Burimi: Arkivi i OMik-ut, KQZ



36 - Partesh	-	-	-	-	-	-	-	-
37 - Kllokoti	-	-	-	-	-	-	-	-
38 - Mitrovicë e Veriut	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>GJITHSEJ</b>	<b>120</b>	<b>84</b>	<b>36</b>	<b>96</b>	<b>12</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>3</b>

Burimi: Arkivi i OMIK-ut, KQZ

Tabela 18: Përfaqësimi nga deputetët e Kuvendit të Kosovës 2010

Komuna	Ulëse të fituara në Kuvend	Gjinia		Etnia				
		Burra	Gra	Shqiptare	Serbe	B/G	RAE	Turke
1 - Deçan	3	1	2	3	-	-	-	-
2 - Gjakovë	5	1	4	5	-	-	-	-
3 - Glogovc	3	2	1	3	-	-	-	-
4 - Gjilan	4	2	2	4	-	-	-	-
5 - Dragash	1	1	-	-	-	1	-	-
6 - Istog	1	-	1	1	-	-	-	-
7 - Kaçanik	1	1	-	1	-	-	-	-
8 - Klinë	-	-	-	-	-	-	-	-
9 - Fushë Kosovë	1	1	-	1	-	-	-	-
10 - Kamenicë	-	-	-	-	-	-	-	-
11 - Mitrovicë	6	5	1	4	2	-	-	-
12 - Leposaviq	-	-	-	-	-	-	-	-
13 - Lipjan	5	5	-	2	2	-	1	-
14 - Novobërdë	1	1	-	-	1	-	-	-
15 - Obiliq	-	-	-	-	-	-	-	-
16 - Rahovec	2	1	1	1	1	-	-	-
17 - Pejë	-	-	-	-	-	-	-	-
18 - Podujevë	1	1	-	1	-	-	-	-
19 - Prishtinë	45	31	14	45	-	-	-	-
20 - Prizren	13	10	3	5	-	4	1	3
21 - Skenderaj	1	-	1	1	-	-	-	-
22 - Shtime	1	1	-	1	-	-	-	-
23 - Shtërpçë	2	-	2	-	2	-	-	-
24 - Suharekë	6	4	2	6	-	-	-	-
25 - Ferizaj	3	2	1	2	-	-	1	-
26 - Viti	-	-	-	-	-	-	-	-
27 - Vushtrri	1	-	1	1	-	-	-	-
28 - Zubin Potok	-	-	-	-	-	-	-	-
29 - Zveçan	-	-	-	-	-	-	-	-
30 - Malishevë	3	2	1	3	-	-	-	-
31 - Juniku	-	-	-	-	-	-	-	-
32 - Mamusha	-	-	-	-	-	-	-	-
33 - Hani i Elezit	-	-	-	-	-	-	-	-
34 - Graçanica	4	2	2	-	4	-	-	-
35 - Ranillugu	1	-	1	-	1	-	-	-





30 - Malishevë	2	1	1	2	-	-	-	-
31 - Juniku	-	-	-	-	-	-	-	-
32 - Mamusha	-	-	-	-	-	-	-	-
33 - Hani i Elezit	-	-	-	-	-	-	-	-
34 - Graçanica	3	3	-	-	3	-	-	-
35 - Ranillugu	-	-	-	-	-	-	-	-
36 - Partesh	-	-	-	-	-	-	-	-
37 - Kllokoti	-	-	-	-	-	-	-	-
38 - Mitrovica e Veriut	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>GJITHSEJ</b>	<b>120</b>	<b>81</b>	<b>39</b>	<b>100</b>	<b>10</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>2</b>

Burimi: KQZ

Tabelë përmblledhëse e deputetëve të Kuvendit të Kosovës sipas gjinisë dhe etnisë nga viti 2001 - 2014

Viti i zgjedhjeve	Ulëset e ndara në Kuvend	Gjinia		Etnia				
		Burra	Gra	Shqiptare	Serbe	Boshnjake e gorane	Rome, ashkali e egjiptase	Turke
2001	120	88	32	87	22	5	3	3
2004	120	85	35	98	10	5	4	3
2007	120	84	36	96	12	4	5	3
2010	120	84	36	94	14	5	4	3
2014	120	81	39	100	10	4	4	2



## KAPITULLI VII - MJETET JURIDIKE

### Korigjimi, sanksionimi, gjykimi në procesin zgjedhor

Ky kapitull, përmban informata bazike për numrin e rasteve që janë klasifikuar dhe gjykuar në formë të ankesës apo parashtresës që nga viti 2000 (për të përcaktuar se çka përbën ankesë apo parashtresë, klasifikimi i përdorur nga organi përkatës ishte autoritativ).

Për sa u përket mjeteve juridike në dispozicion si dhe kuadrit organizativ të sistemit të mjeteve juridike, ka pasur një numër të ndryshëm të tyre që nga viti 2000, në aspekte të tjera të procesit zgjedhor. Nga viti 2000 deri 2002, ka pasur organe të ndryshme përgjegjëse për shqyrtimin e ankesave apo parashtresave varësisht nga natyra e rastit:

- Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të OKB-së kishte autoritet të përgjithshëm mbi procesin zgjedhor, i cili përfshinte, ndër të tjera, autoritetin për të revokuar apo pezulluar vendimet e marra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, certifikuar procesin e regjistrimit të votuesve (2000) ose listën e votuesve (2001, 2002), rezultatet e zgjedhjeve, si dhe për të urdhëruar rinumërimin e votave, ose kërkuar përsëritjen e zgjedhjeve në disa apo të gjitha vendvotimet ose qendrat e votimit.
- Vendimet për regjistrimin e një partie politike janë marrë nga një komision i specializuar për shqyrtim administrativ pa mundësinë e shqyrtimit gjyqësor.
- Ankesat dhe parashtresat e lidhura me regjistrimin e votuesve [kundër vendimit të Task Forcës së Përbashkët të Regjistrimit (2000) ose të Drejtorit të Departamentit të Operacioneve të Zgjedhjeve të OSBE-së (2001, 2002), janë gjykuar nga Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), duke përfshirë ankesat dhe parashtresat jashtë Kosovës lidhur me revokimin e lejes për inspektim të listës së votuesve (2000);
- Të gjitha ankesat e tjera (në lidhje me procesin zgjedhor, fushatën, votimin, numërimin, etj.) janë gjykuar nga KZAP.

- Në atë kohë, Nënkomisioni Zgjedhor për Ankesa e Parashtresa ishte nënkomision i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe autoriteti i tij nuk mbulonte asnjë mjet juridik kundër vendimeve të KQZ-së. KZAP-i, përveç kësaj, ishte vetëm organ i përkohshëm, i themeluar vetëm për procesin zgjedhor dhe funksionalitetin e tij. Nuk parashihej asnjë shqyrtim gjyqësor nga gjykatat.

Në vitin 2004 janë aplikuar ndryshime në sistemin e mjeteve juridike

- PSSP i OKB-së kishte autoritet të përgjithshëm për certifikimin e rezultateve, por autorizimet e tjera (certifikimi i listës zgjedhore, urdhërimi i rinumërimit ose vendimi për përsëritjen e zgjedhjeve) u është deleguar organeve të tjera (KQZ-së dhe pjesërisht KZAP-së).
- KZAP-i mori përgjegjësi për t'i rishikuar disa vendime të përzgjedhura të KQZ-së (përfshirë ankesat lidhur me regjistrimin e votuesve, certifikimin e subjekteve politike ose listën e tyre të kandidatëve, akreditimin e vëzhguesve, etj.) dhe mund të udhëzonte KQZ-në që të urdhërojë rinumërim të fletëvotimeve apo të përsërisë votimin;

Në vitin 2004, KZAP u formua si organ i veçantë i emëruar nga PSSP-ja (jo më nënkomision i KQZ-së), por KZAP vazhdoi të mbesë trup i përkohshëm.

Në vitin 2007, nuk ndodhën ndryshime të mëdha në kompetencat dhe natyrën e përkohshme të KZAP, por përbërja e tij ndryshoi dhe tani gjyqtarët e Gjykatës Supreme dhe Gjykatave të Qarkut u emëruan në KZAP.

Që nga viti 2008 këto ndryshime u realizuan në sistemin e mjeteve juridike dhe KZAP:

- Emri i KZAP u ndryshua në Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) më 2010,
- Ai u bë organ i përhershëm më përbërje vetëm nga gjyqtarë vendorë,
- Rishikimi i vendimeve të KQZ-së për regjistrimin e partive politike është shtuar në listën e autorizimeve, por, shqyrtimi i ankesave për sa i përket sfidimit të listës së votuesve është bartur në gjykata (vetëm rishikim i kërkesave për programin e votimit jashtë vendit mbeti pranë PZAP-së).

Disa faktorë të ndryshëm e vështirësojnë krahasimin e praktikës së KZAP/PZAP mes 2000 dhe 2014:

- a) Ndryshimet e rëndësishme të cekura më lartë në autorizimet e KZAP/PZAP (për shembull numri i lartë i ankesave të lidhura me listën e votuesve në një vit dhe mungesa e autoritetit për sa i përket kësaj në vitin tjetër e pamundëson krahasimin e praktikës, vetëm duke marrë parasysh numrat e rasteve).
- b) Ndryshimi në sistemet e arkivimit dhe regjimet e shqyrtimit (d.m.th si klasifikohen, bashkohen apo ndahen rastet në dosje) të organeve të ndryshme të mjeteve juridike.

Në këtë kuptim, një sistem i unifikuar i bazuar në atë se sa herë ka ndodhur shkelja e dispozitave ligjore do të siguronte një pasqyrë më të mirë, por kjo do të kërkonte tërë riklasifikimin e të gjitha rasteve/dosjeve që nga viti 2000. Prandaj, tabela 20 paraqet informatat bazike për numrin e rasteve të parashtruara që nga viti 2000. “Numri i rasteve (ankesave dhe parashtresave)” nënkupton numrin e dosjeve fizike që KZAP/PZAK ka regjistruar me numër të veçantë të rastit, dhe shpërndarjen e tyre të brendshme sipas fazave të ndryshme të zgjedhjeve. Gjithashtu, aty mund të gjendeni nformata bazike mbi numrin e ankesave/parashtresave të suksesshme dhe gjobave të shqiptuara.

Ndarja e brendshme e rasteve, është si në vijim (sipas klasifikimit të përdorur nga KZAP/PZAP):

- Më 2000: nga 319 raste, 125 kanë të bëjnë me ditën e zgjedhjeve, 2 me numërimin dhe 192 me faza të tjera të procedurës zgjedhore.<sup>30</sup> Përveç kësaj, KZAP ka gjykuar 4852 raste që kanë të bëjnë me vendimet për regjistrimin e votuesve dhe aplikacionet për votim jashtë vendit.<sup>31</sup>
- Më 2001: nga 276 raste, 41 kanë të bëjnë me ditën e zgjedhjeve, dhe 235 me faza të tjera të procedurës zgjedhore.<sup>32</sup> Përveç kësaj, KZAP ka gjykuar

---

<sup>30</sup> Burimi: Arkivi i OSBE

<sup>31</sup> Burimi: Raporti final i KZAP 2000

<sup>32</sup> Burimi: Arkivi i OSBE

5089 raste që kanë të bëjnë me vendimet për regjistrimin e votuesve dhe aplikacionet për votim jashtë vendit.<sup>33</sup>

- Më 2002: nga 294 raste, 53 kanë të bëjnë me ditën e zgjedhjeve, dhe 241 me faza të tjera të procedurës zgjedhore.<sup>34</sup> Përveç kësaj, KZAP ka gjykuar 1425 raste që kanë të bëjnë me vendimet për regjistrimin e votuesve dhe aplikacionet për votim jashtë vendit.<sup>35</sup>
- Më 2004: nga 254 raste, 73 kanë të bëjnë me ditën e zgjedhjeve, 46 janë klasifikuar si parashtresa (shumica kishin të bënin me regjistrimin e votuesve) dhe 135 raste janë klasifikuar si ankesë (që kishin të bënin me fazat e tjera të procesit zgjedhor).<sup>36</sup>
- Më 2007: 390 raste nuk janë ndarë më tutje në faza zgjedhore apo ndryshe.<sup>37</sup>
- Më 2009: çështjet e pretenduara në 544 raste janë shpërndarë si në vijim (disa ankesa/parashtresa të klasifikuara në më shumë se një kategori): 73 kanë të bëjnë me shkeljen e Kodit të Mirësjelljes, 40 me raportin për financimin e fushatës, 292 me ditën e zgjedhjeve, 60 me numërimin, 10 me ndarjen votave për subjektin e gabuar dhe 26 të tjera.<sup>38</sup>
- Më 2010: nga 454 ankesa, 147 kanë të bëjnë me shkelje të kodit të mirësjelljes, 33 me kërcënime dhe rrezikime, 255 me ditën e zgjedhjeve, 19 me rezultatet, gjersa nga 15 parashtresa 6 kanë të bëjnë me certifikimin e kandidatit, 1 me dështimin për të dorëzuar raport të financimit të fushatës, 1 me çregjistrimin e partisë politike, ndërsa të tjerat me kërkonin rishqyrtim të vendimeve të mëparshme të PZAP-së.<sup>39</sup>
- Më 2013: nga 1109 raste, 33 kanë të bëjnë me fazën e fushatës parazgjedhore, 258 me periudhën e fushatës, 32 me periudhën e heshtjes zgjedhore, 254 me ditën e zgjedhjeve, 245 me rezultatet

<sup>33</sup> Burimi: Raporti final i KZAP 2001

<sup>34</sup> Burimi: Arkivi i OSBE

<sup>35</sup> Burimi: Raporti final i KZAP 2002

<sup>36</sup> Burimi: Arkivi i OSBE

<sup>37</sup> Burimi: Arkivi i OSBE

<sup>38</sup> Burimi: Raporti vjetor i PZAP tetor 2009 – korrik 2010

<sup>39</sup> Burimi: Raporti i PZAP për procesin zgjedhor 2010-2011 (1 nëntor 2010 – 28 shkurt 2011). Nuk janë përfshirë zgjedhjet e jashtëzakonshme më 2010 dhe 2012.

preliminare, 0 me procedurat e qendrës për numërim dhe rezultate, 282 me rezultatet përfundimtare; 5 me kandidatët për kryetarë komunash. Përveç kësaj, PZAP ka gjykuar 16410 parashtresa ndaj vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për refuzimin e aplikacioneve që janë dërguar nga aplikuesit me vendqëndrim ose vendbanim në Serbi;<sup>40</sup>

- Më 2014: nga 341 raste, 7 kishin të bënin me fazën e fushatës parazgjedhore, 159 me periudhën e fushatës, 36 me periudhën e heshtjes zgjedhore, 47 me ditën e zgjedhjeve, 21 me rezultatet preliminare, 6 me procedurat e qendrës për numërim dhe rezultate, 65 me rezultatet përfundimtare. Përveç kësaj, PZAP ka gjykuar 9172 parashtresa ndaj vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për refuzimin e aplikacioneve që janë dërguar nga aplikuesit me vendqëndrim ose vendbanim në Serbi.<sup>41</sup>

---

<sup>40</sup> Burimi: Raporti vjetor i PZAP 2013

<sup>41</sup> Burimi: Raporti vjetor i PZAP 2014

Tabela 20: Mjetet juridike<sup>42</sup>

	KUVEND KOMUNAL 2000	KUVEND TË KOSOVËS 2001	KUVEND KOMUNAL 2002	KUVEND TË KOSOVËS 2004	KUVEND TË KOSOVËS, KUVEND KOMUNAL & KRYETAR KOMUNASH 2007	KUVEND KOMUNAL & KRYETAR KOMUNASH 2009	KUVEND TË KOSOVËS 2010	KUVEND KOMUNAL & KRYETAR KOMUNASH 2013	KUVEND TË KOSOVËS 2014
1. Gjithsej numri i rasteve	319	276	294	254	390	544	469	1109	341
Nga të cilat 1.1 Ankesa	319 <sup>43</sup>	276 <sup>43</sup>	294 <sup>43</sup>	208 <sup>43</sup>	253 <sup>43</sup>	519	454	1064	326
1.2 Parashtrësia	0	0	0	46	137	25	15	45	15
2. Ankesa dhe parashtrësia të aprovuara %	25 (7.8%)	110 (39.9%)	147 (50%)	85 (33.5%)	126 (32.3%)	115 (21.1%)	151 (32.2%)	125 (11.3%)	96 (28.2%)
3. Shuma e gjobave të shqiptuara (EUR)	18,406.51 (36,000 DEM)	36,557.38 (71500DEM), 6000 EUR	66,075	111,056.16	87,575	210,170	377,450	190,550	86,700

Burimi: Arkivi i OSBE, PZAP

<sup>42</sup> Për të dhënat për ndarjen e brendshme të rasteve, si dhe për burimet e të dhënave, shihni më lart.

<sup>43</sup> Përfshirë rastet *ex officio* (ku KQZ dhe OSBE kanë iniciuar ankesën)



## PJESA II – PROCEDURA ZGJEDHORE

Përderisa pjesa e parë e këtij raporti kishte të bënte me të dhënat historike të zgjedhjeve, kjo pjesë përfshin diagrame që shpjegojnë elementet kryesore të procesit zgjedhor nga perspektiva e legjislacionit në fuqi. Temat janë paraqitur në vijim:

- a) *Aktivitetet kryesore të procesit zgjedhor (tabela 21),*
- b) *Diagrami që shpjegon shpalljen e zgjedhjeve (tabelat 22-23),*
- c) *Diagrami që shpjegon procesin e regjistrimit të partive politike (tabela 24),*
- d) *Diagrami që shpjegon procesin e certifikimit të subjekteve politike (tabela 25),*
- e) *Tabela me afatet kryesore ligjore të cilat duhet t'i përmbush çdo parti politike (tabela 26),*
- f) *Tabelat me numrin minimal të kandidatëve të emëruar nga gjinia e kundërt (tabelat 27-28),*
- g) *Diagrami që shpjegon emërimin e KKZ-ve dhe KVV-ve (tabelat 29-30),*
- h) *Diagrami që shpjegon numërimi (tabelat 31),*
- i) *Tabela që demonstroi metodën e ndarjes së vendeve për deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Kosovës (tabela 32),*
- j) *Diagrami që shpjegon punën e sistemit të mjeteve juridike (tabela 33).*

Tabela 21: Aktivitetet kryesore të zgjedhjeve

	Aktiviteti	Zgjedhjet e rregullta	Zgjedhjet e parakohshme
1	Shpallja e zgjedhjeve	Zgjedhjet shpallen 4-6 muaj para ditës së zgjedhjeve <u>Ligji 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme (LZP) neni 4.3</u>	Zgjedhjet shpallen 20-45 ditë para ditës së zgjedhjeve. <u>Neni 4.5 i LZP</u>
2	Kufizimi i shpenzimeve të fushatës	Kufizimi i shpenzimit të fushatës (përgjithësisht 0.5 euro për votues të regjistruar) përcaktohet nga KQZ jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve. <u>LZP neni 39,1; Rregulli zgjedhor (RRZ) 12/2013 neni 3.1</u>	Kufizimi i shpenzimit të fushatës (përgjithësisht 0.5 euro për votues të regjistruar) përcaktohet me vendimin e KQZ për caktimin e afateve për zgjedhjet e parakohshme. <u>LZP neni 39,1; RRZ 12/2013 neni 3.1, RRZ 15/2013 neni 3.1.6</u>
3	Komisionet Komunale të Zgjedhjeve	KKZ-të emërohen brenda 15 ditëve pas shpalljes <u>Neni 67.4 i LZP</u>	KKZ-të emërohen brenda afatit të përcaktuar me vendim të KQZ që cakton afatet e zgjedhjeve të parakohshme. <u>RRZ 15/2013 neni 3.1.9</u>
4	Pjesëmarrja e partive politike në zgjedhje	Brenda 15 ditëve pas shpalljes, partia politike duhet ta njoftojë Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike (Zyrën) që nuk konteston zgjedhjet apo që synon të certifikohet si pjesë e koalicionit. <u>LZP neni 15; RRZ 03/2013 neni 1.3</u>	Njoftimi bëhet brenda afatit të përcaktuar me vendim të KQZ që cakton afatet e zgjedhjeve të parakohshme. <u>RRZ 15/2013 neni 3.1.2</u>
5	Votimi jashtë Kosovës	Aplikacionet mund të dorëzohen në periudhën ndërmjet 25 ditëve pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve dhe 60 ditë para ditës së zgjedhjeve. <u>RRZ 03/2008 neni 3.5</u>	Aplikacionet duhet të dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me vendim të KQZ që cakton afatet e zgjedhjeve të parakohshme. <u>RRZ 15/2013 neni 3.1.11</u>
6	Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve	Aplikimi për certifikim mund të dorëzohet në Zyrë jo më vonë se 60 ditë para zgjedhjeve. <u>LZP neni 15,2; RRZ 08/2013 nenet 3.1 dhe 5.1</u>	Aplikimi për certifikim mund të dorëzohet në Zyrë brenda afatit të përcaktuar me vendim të KQZ që cakton afatet e zgjedhjeve të parakohshme. <u>RRZ 15/2013 neni 3.1.2</u>

7	Shërbimet për votues	Kërkesat për ndryshim të Qendrës së caktuar të Votimit mund të dorëzohen në periudhën ndërmjet 35 ditëve pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve dhe 40 ditë para ditës së zgjedhjeve. <b>RRZ 17/2013 neni 4.2</b>	Nuk saktësohet në RRZ 15/2013
8	Periudha e kundërshtimit	Votuesit me të drejtë vote mund të kundërshtojnë përfshirjet në listë të votimit, mospërfshirjes dhe pasaktësitë në periudhën ndërmjet 54 dhe 40 ditëve para ditës së zgjedhjeve. <b>LZP neni 10,4 dhe 10.4; RRZ 02/2013 neni 3.8</b>	Votuesit me të drejtë vote mund të kundërshtojnë përfshirjet në listë të votimit, mospërfshirjes dhe pasaktësitë brenda periudhës së përcaktuar me vendimin e KQZ që cakton afatet e zgjedhjeve të parakohshme. <b>RRZ 15/2003 neni 3.1.1</b>
9	Tërheqja e subjektit politik	Një subjekt i certifikuar politik mund të tërhiqet nga zgjedhjet përmes dorëzimit të konfirmimit me shkrim jo më vonë se dy ditë pune para hedhjes së shortit. <b>LZP neni 28,1; RRZ 08/2013 neni 7.1</b>	Një subjekt i certifikuar politik mund të tërhiqet nga zgjedhjet përmes dorëzimit të konfirmimit me shkrim deri në afatin e përcaktuar nga KQZ që cakton afatet e zgjedhjeve të parakohshme. <b>RRZ 15/2003 neni 3.1.3</b>
10	Shorti i fletëvotimit	Shorti i fletëvotimit do të mbahet jo më vonë se 45 ditë para ditës së zgjedhjeve <b>LZP neni 24,1; RRZ 08/2013 neni 10.1</b>	Shorti i fletëvotimit mbahet brenda afatit të përcaktuar me vendim të KQZ që cakton afatet e zgjedhjeve të parakohshme. <b>RRZ 15/2003 neni 3.1.3</b>
11	Këshillat e vendvotimeve	Emërimet e subjekteve politike dorëzohen tek KKZ brenda 5 ditëve pas kërkesës së Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve <b>LZP neni 76 dhe 77; RRZ 19/2016 neni 4.6</b>	Emërimet e subjekteve politike dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me vendim të KQZ që cakton afatet e zgjedhjeve të parakohshme. <b>RRZ 15/2013 neni 3.1.9</b>
12	Konfirmimi i listës së votuesve	Pas periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve certifikon listën e votuesve. <b>LZP neni 8,6; RRZ 02/2013 neni 3.11</b>	Pas periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve certifikon listën e votuesve. <b>LZP neni 8,6; RRZ 02/2013 neni 3.11, RRZ 15/2013 neni 3.3</b>
13	Lokacionet e votimit	Lokacioni i vendvotimeve shpallet jo më vonë se 40 ditë para zgjedhjeve.	Lokacionet e vendvotimeve shpallen brenda afatit të përcaktuar me vendim të

		<u>LZP neni 83.1; RRZ 16/2013 neni 7.1</u>	KQZ që cakton afatet e zgjedhjeve të parakohshme. <u>RRZ 15/2013 neni 3.1.10</u>
14	Vëzhguesit	Duhet të dorëzohen aplikacionet për akreditim a) për organizatat jo më vonë se 25 ditë para ditës së zgjedhjeve; për vëzhgim të ditës së zgjedhjeve jo më vonë se 20 ditë para ditës së zgjedhjeve; b) për individët në emër të organizatave jo më vonë se 30 ditë para zgjedhjeve. <u>LZP neni 54.3; 54.4 dhe 54.5; RRZ 07/2013 neni 3.1; 3.2; 3.3</u>	Afatet për akreditim dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me vendim të KQZ që cakton afatet e zgjedhjeve të parakohshme. <u>RRZ 15/2013 neni 3.1.8</u>
15	Akreditimi i mediave	Zyra duhet të njoftohet për datën që pjesëtarët e kompanive mediale dëshirojnë të hyjnë në vendvotime, qendra të votimit apo Qendër të Numërimit dhe Rezultateve jo më vonë se 15 ditë para ditës së zgjedhjeve. <u>RRZ 7/2013 neni 5.2</u>	Zyra duhet të njoftohet për datën që pjesëtarët e kompanive mediale dëshirojnë të hyjnë në vendvotime, qendra të votimit apo Qendër të Numërimit dhe Rezultateve jo më vonë se 15 ditë para ditës së zgjedhjeve. <u>LZP 7/2013 neni 5.2; RRZ 15/2013 neni 3.3</u>
16	Periudha e fushatës zgjedhore	Fushata zgjedhore është 30 ditë, dhe përfundon një ditë para ditës së zgjedhjeve. <u>LZP neni 3; RRZ 13/2013 neni 2.1</u>	Kohëzgjatja e periudhës së fushatës përcaktohet me vendimin e KQZ që përcakton afatet e zgjedhjeve të parakohshme, dhe përfundon një ditë para ditës së zgjedhjeve. <u>RRZ 15/2013 neni 3.1.7</u>
17	Votimi i personave me nevoja të veçanta	votuesit me të drejtë vote të cilët nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre, me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion dhe votuesit që jetojnë në rrethana të veçanta mund të regjistrohen për programin e votimit për votues me nevoja të veçanta pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se 15 ditë (në rastin e votuesve që nuk mund të	votuesit me të drejtë vote të cilët nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre, me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion dhe votuesit që jetojnë në rrethana të veçanta mund të regjistrohen për programin e votimit për votues me nevoja të veçanta pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve deri në afatin e

		<p>dalim nga shtëpia ndërmjet 60 dhe 15 ditëve) para ditës së zgjedhjeve.  <u>LZP neni 99; RRZ 04/2013 nenet 3.1, 5.1 dhe 6.1</u></p>	<p>përcaktuar me vendimin e KQZ për caktimin e afateve të zgjedhjeve të parakohshme.  <u>RRZ 15/2013 neni 3.1.12</u></p>
18	Votimi jashtë Kosovës - afati i votimit	<p>Votat jashtë Kosovës duhet të pranohen 24 orë para ditës së zgjedhjeve.  <u>LZP neni 96,2; RRZ 03/2013 neni 4.4</u></p>	<p>Votat jashtë Kosovës duhet të pranohen 24 orë para ditës së zgjedhjeve.  <u>LZP neni 96,2; RRZ 03/2013 neni 4.4, RRZ 15/2013 neni 3.3</u></p>
19	<b>DITA E ZGJEDHJEVE</b>		
20	Certifikimi i rezultateve	<p>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve certifikon rezultatet pas shqyrtimit të të gjitha ankesave dhe përpilimit të rezultateve.  <u>Neni 106.1 i LZP</u></p>	<p>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve certifikon rezultatet pas shqyrtimit të të gjitha ankesave dhe përpilimit të rezultateve.  <u>Neni 106.1 i LZP</u></p>
21	Balotazhi për kryetarë të komunave - afati për aplikim të vëzhguesve	<p>Aplikacionet e vëzhguesve pranohen jo më vonë se 5 ditë para ditës së zgjedhjeve  <u>RRZ 10/2013 neni 4.2</u></p>	<p>Aplikacionet e vëzhguesve pranohen jo më vonë se 5 ditë para ditës së zgjedhjeve  <u>LZP 10/2013 neni 4,2; RRZ 15/2013 neni 3.3</u></p>
22	Balotazhi për kryetarë të komunave - periudha e fushatës	<p>Periudha e fushatës zgjedhore caktohet me vendim të KQZ, dhe përfundon një ditë para ditës së zgjedhjeve.  <u>RRZ 10/2013 neni 2.2</u></p>	<p>Periudha e fushatës zgjedhore caktohet me vendim të KQZ, dhe përfundon një ditë para ditës së zgjedhjeve.  <u>LZP 10/2013 neni 2,2; RRZ 15/2013 neni 3.3</u></p>
23	Balotazhi për kryetarë të komunave - këshillat e vendvotimeve	<p>Ekipet e vendvotimeve emërohen jo më vonë se 7 ditë para ditës së zgjedhjeve  <u>RRZ 10/2013 neni 5.5</u></p>	<p>Ekipet e vendvotimeve emërohen jo më vonë se 7 ditë para ditës së zgjedhjeve  <u>LZP 10/2013 neni 5,5; RRZ 15/2013 neni 3.3</u></p>
24	Balotazhi për kryetarë të komunave - afati për votim jashtë vendit	<p>Votat jashtë Kosovës duhet të pranohen 24 orë para ditës së zgjedhjeve.  <u>LZP neni 96,2; RRZ 03/2013 neni 4.4</u></p>	<p>Votat jashtë Kosovës duhet të pranohen 24 orë para ditës së zgjedhjeve.  <u>LZP neni 96,2; RRZ 03/2013 neni 4.4, RRZ 15/2013 neni 3.3</u></p>
25	Dita e zgjedhjeve - balotazhi për	<p>Dita e zgjedhjeve do të mbahet të dielën 4 javë pas raundit të parë</p>	<p>Dita e zgjedhjeve do të mbahet të dielën 4 javë pas raundit të parë</p>


	kryetarë të komunave	<u>Ligji 03/L-072 për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës (LZL) neni 9.6</u>	<u>Ligji 03/L-072 për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës (LZL) neni 9.6</u>
26	Certifikimi i rezultateve të balotazhit	KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendotime dhe në qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga Komisioni Zgjedhor për Parashtresat dhe Ankesat dhe nga Gjykata Kushtetuese Komisioni Qendror i Zgjedhjeve certifikon rezultatet pas shqyrtimit të të gjitha ankesave dhe përpilimit të rezultateve. <b>Neni 106.1 i LZP</b>	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve certifikon rezultatet pas shqyrtimit të të gjitha ankesave dhe përpilimit të rezultateve. <b>Neni 106.1 i LZP</b>
27	Tarifat për certifikim	Subjekteve politike që fitojnë së paku një vend do tu kthehet depoziti brenda 30 ditëve pas certifikimit të rezultateve. <b>RRZ 08/2013 neni 9.2</b>	Subjekteve politike që fitojnë së paku një vend do tu kthehet depoziti brenda 30 ditëve pas certifikimit të rezultateve. <b>LZP 08/2013 neni 9.2; RRZ 15/2013 neni 3.3</b>
28	Raporti i financimit të fushatës - raundi i parë	Çdo subjekt i certifikuar politik duhet të dorëzojë raportin e shpenzimit të fushatës në zyrë jo më vonë se 45 ditë pas ditës së zgjedhjeve. <b>LZP neni 40.1; RRZ 12/2013 neni 4.1</b>	Çdo subjekt i certifikuar politik duhet të dorëzojë raportin e shpenzimit të fushatës në zyrë jo më vonë se 45 ditë pas ditës së zgjedhjeve. <b>LZP neni 40.1; RRZ 12/2013 neni 4.1, RRZ 15/2013 neni 3.3</b>
29	Raporti i financimit të fushatës - balotazhi	Çdo subjekt i certifikuar politik duhet të dorëzojë raportin e shpenzimit të fushatës në zyrë jo më vonë se 45 ditë pas ditës së zgjedhjeve. <b>RRZ 10/2013 neni 10</b>	Çdo subjekt i certifikuar politik duhet të dorëzojë raportin e shpenzimit të fushatës në zyrë jo më vonë se 45 ditë pas ditës së zgjedhjeve. <b>LZP 10/2013 neni 10; RRZ 15/2013 neni 3.3</b>
30	Materialet sensitive	Materialet shkatërrohen brenda 60 ditëve pas certifikimit të rezultateve (përveç nëse udhëzohet ndryshe nga PZAP)	Materialet shkatërrohen brenda 60 ditëve pas certifikimit të rezultateve (përveç nëse udhëzohet ndryshe nga PZAP)

		<b>Neni 103.4 i LZP</b>	<b><u>LZP neni 103.4; RRZ 15/2013 neni 3.3</u></b>
31	<b>Auditimi i raporteve vjetore financiare dhe raporteve të deklarimit financiar të fushatës</b>	<p>Raportet Vjetore Financiare dhe Raport të Deklarimit Financiar të Fushatës të cilat dorëzohen nga subjektet politike në KQZ, do të auditohen në përputhje me standardet e kontabilitetit të zbatueshme në Kosovë, nga auditorë të cilët do ti përzgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike nëpërmjet një thirrje të hapur publike për aplikim. <u>Ligji per Financimin e Subjekteve politike (LFSP)nr.03/L-174 i ndryshuar nr 04/L-058 i plotësuar dhe ndryshuar nr.04/L-212 neni 19</u></p>	<p>KQZ - ja ia paraqet rezultatet paraprake të kontrollimit të raportit vjetor financiar nga auditorët organit më të lartë ekzekutiv të subjektit politik, duke përfshirë edhe listën e gabimeve ose lëshimeve brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga fillimi i kontrollimit. Procesi i auditimit të Raporteve vjetore financiare të subjekteve politike duhet të mbarojë më së largu deri më 15 qershor të vitit pasues. <u>LFSP nr.03/L-174 i ndryshuar nr 04/L-058 i plotësuar dhe ndryshuar nr.04/L-212 neni 19</u></p>
32	<b>Auditimi i financimit të fushatës - raporti final i auditimit</b>	<p>KQZ-ja duhet t'i publikoj dhe t'i mbaj të publikuar të gjitha raportet vjetore financiare të subjekteve politike së bashku me raportin përfundimtar të auditimit të subjekteve politike në faqen e saj zyrtare më së largu deri më 30 qershor të vitit pasues. Po ashtu, deri më këtë datë KQZ-ja obligohet t'i përcjellë subjektit politik raportin përfundimtar të auditimit. <u>LFSP nr.03/L-174 i ndryshuar nr 04/L-058 i plotësuar dhe ndryshuar nr.04/L-212 neni 19; Neni 10 i Rregulles Zgjedhore nr.14/2015</u></p>	<p>KQZ-ja obligohet t'i përcjellë deri më 30 qershor të vitit pasues raportet vjetore financiare të subjekteve politike së bashku me raportin përfundimtar të auditimit të subjekteve politike dhe më së largu deri më gjashtë (6) muaj pas ditës së mbajtje së zgjedhjeve raportin financiar të fushatës së subjekteve politike së bashku me raportin përfundimtar të auditimit të subjekteve politike për në Agjencinë Anti Korrupsion, e cila në përputhje me mandatin të saj mund të ekzaminoj këto raporte. <u>LFSP nr.03/L-174 i ndryshuar nr 04/L-058 i plotësuar dhe ndryshuar nr.04/L-212 neni 19; Neni 10 i Rregulles Zgjedhore nr.14/2015</u></p>

## Tabela 22: Shpallja dhe mbajtja e zgjedhjeve për Kuvend të Kosovës

Zgjedhjet shpallen ndërmjet 5-8 muaj, si dhe mbahen ndërmjet 30-60 ditësh, para përfundimit të mandateve të Kuvendit<sup>44</sup>

Zgjedhjet e parakohshme<sup>45</sup> mund të mbahen ndërmjet 30-45 ditësh pas shpërndarjes së Kuvendit




<sup>44</sup> Pas konsultimit me parti politike, Presidenti cakton dhe shpall ditën e zgjedhjeve (LZP neni 4.1). Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve publikohet në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

<sup>45</sup> Presidenti thërret zgjedhjet e parakohshme jo më vonë sesa 10 ditë pas shpërbërjes së Kuvendit (LZP, neni 4).




### Tabela 23: Shpallja dhe mbajtja e zgjedhjeve lokale

Zgjedhjet shpallen brenda 3-8 muajsh, si dhe mbahen brenda një periudhe 90-ditëshe përreth përfundimit të mandateve të Kuvendeve Komunale<sup>46</sup>  
Zgjedhjet e jashtëzakonshme duhen mbajtur ndërmjet 30-45 ditë pas shpërbërjes së Kuvendit Komunal apo shkarkimit të kryetarit të komunës<sup>47</sup>



<sup>46</sup> Pas konsultimit me parti politike, Presidenti cakton dhe shpall ditën e zgjedhjeve (LZL neni 4.1). Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve publikohet në Gazetën Zyrtare të Kosovës

<sup>47</sup> Presidenti shpall zgjedhjet e parakohshme jo më vonë se 10 ditë pas shpërbërjes së Kuvendit Komunal apo shkarkimit të Kryetarit (LZL Neni 4.4 dhe 11.2).

Tabela 24: Procesi i regjistrimit të partive politike<sup>48</sup>

<sup>48</sup> Zyra duhet që brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i kërkesës, të informojë KQZ-në për statusin e aplikimit duke rekomanduar regjistrimin, refuzimin e regjistrimit, apo duke specifikuar pikat që mund të kërkojnë sqarime të mëtejshme

Tabela 25: Procesi i certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve




Tabela 26: Partitë Politike – Kërkesat ligjore

<p><b>31 JANAR</b></p> <p><b>TË DHËNAT E REGJISTRUARA</b></p>	<p>Deri më 31 janar, të gjitha partitë duhet të dorëzojnë të dhënat e përditësuara gjatë vitit paraprak.</p> <p><b><u>RRZ 01/2013 Neni 11</u></b></p>
<p><b>01 MARS</b></p> <p><b>RAPORTET FINANCIARE</b></p>	<p>Deri më 1 mars, partitë janë të obliguara të dorëzojnë Raportin Vjetor Financiar për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor për vitin paraprak.</p> <p><b><u>Ligji nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike (LFPP) Neni 15.1; RRZ 14/2013 neni 3.3.b, 7</u></b></p>
<p><b>31 MARS</b></p> <p><b>VAZHDIMI I REGJISTRIMIT</b></p>	<p>Deri më 31 mars, të gjitha partitë janë të obliguara të konfirmojnë që duan të mbeten të regjistruara si parti politike.</p> <p><b><u>LZP neni 12.6, RRZ 01/2013 – neni 7</u></b></p>
<p><b>30 QERSHOR</b></p> <p><b>RAPORTET FINANCIARE</b></p>	<p>Deri më 30 qershor, partitë politike janë të obliguara të publikojnë Raportin Financiar Vjetor të vitit paraprak në një gazetë.</p> <p>Raportet e Informatave Financiare të Fushatave duhen publikuar brenda 6 muajsh pas zgjedhjeve në një gazetë.</p> <p><b><u>LFPP Neni 15.5</u></b></p>
<p><b>RAPORTET TREMUJORE</b></p> <p><b>FONDI PËR MBËSHTETJEN E PARTIVE POLITIKE</b></p>	<p>Pas çdo tremujori të vitit, partitë politike janë të obliguara të dorëzojnë raportin për shpenzime nga Fondi për Mbështetjen e partive politike.</p> <p><b><u>RRZ 14/2013 neni 6.2</u></b></p>
<p><b>KUVENDET E PËRGJITHSHME</b></p> <p><b>PARTITË POLITIKE</b></p>	<p>Partia e regjistruar politike duhet të mbajë Kuvendin brenda gjashtë (6) muajsh nga regjistrimi i Partisë dhe së paku çdo dyzetetë (48) muaj më pas.</p> <p><b><u>RRZ 01/2013 neni 15.1</u></b></p>

**Tabela 27: Numri minimal i kandidatëve të nominuar nga gjinia e kundërt/Zgjedhjet lokale**


Nr. i kandidatëve në listë	Numri minimal i gjinisë së kundërt	Nr. i kandidatëve në listë	Numri minimal i gjinisë së kundërt
1	0	29	9
2	1	30	9
3	1	31	10
4	2	32	10
5	2	33	10
6	2	34	11
7	3	35	11
8	3	36	11
9	3	37	12
10	3	38	12
11	4	39	12
12	4	40	12
13	4	41	13
14	5	42	13
15	5	43	13
16	5	44	14
17	6	45	15
18	6	46	15
19	6	47	15
20	6	48	16
21	7	49	16
22	7	50	16
23	7	51	17
24	8	52	17
25	8	53	17
26	8	54	18
27	9	55	18
28	9	56	18

Burimi: Shtojca IV e Rregullit Zgjedhor të KQZ-së 8/2013 për Certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre

**Tabela 28: Numri minimal i kandidatëve nga gjinia e kundërt / Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës**

Nr. i kandidatëve në listë	Numri minimal i gjinisë së kundërt	Nr. i kandidatëve në listë	Numri minimal i gjinisë së kundërt	Nr. i kandidatëve në listë	Numri minimal i gjinisë së kundërt
1	0	41	13	81	25
2	1	42	13	82	25
3	1	43	13	83	25
4	2	44	14	84	26
5	2	45	14	85	26
6	2	46	14	86	26
7	3	47	15	87	27
8	3	48	15	88	27
9	3	49	15	89	27
10	3	50	15	90	27
11	4	51	16	91	28
12	4	52	16	92	28
13	4	53	16	93	28
14	5	54	17	94	29
15	5	55	17	95	29
16	5	56	17	96	29
17	6	57	18	97	30
18	6	58	18	98	30
19	6	59	18	99	30
20	6	60	18	100	30
21	7	61	19	101	31
22	7	62	19	102	31
23	7	63	19	103	31
24	8	64	20	104	32
25	8	65	20	105	32
26	8	66	20	106	32
27	9	67	21	107	33
28	9	68	21	108	33
29	9	69	21	109	33
30	9	70	21	110	33
31	10	71	22		
32	10	72	22		
33	10	73	22		
34	11	74	23		
35	11	75	23		
36	11	76	23		
37	12	77	24		
38	12	78	24		
39	12	79	24		
40	12	80	24		

Tabela 29: Emërimi i Komisionit Komunal Zgjedhor




**Tabela 30: Emërimi i anëtarëve të Komisionit të Vendvotimit**



Tabela 31: Hapat në numërimin e votave në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës





Tabela 32: Metoda e ndarjes së ulëseve për zgjedhjet e anëtarëve të Kuvendit të Kosovës

120 seats	Party 1	Party 2	Party 3	Party 4	Party 5	Party 6	Party 7	Party 8	Party 9	Party 10	Party 11	Party 12	Party 13	Party 14	Party 15	Party 16	Party 17	Party 18	Party 19	Party 20	Party 21	Party 22	Party 23	
Valid Votes	259,381	169,410	93,165	92,611	77,002	60,676	51,385	51,380	4,000	3,661	939	73,000	21,524	1,025	761	489	531	4,251	3,412	984	3,451	3,214	245	
Community	Albanian Party											Serb Community 1	Serb Community 2	Serb Community 3	Rom	Ashkali	Egjiptian	Boshnjak 1	Boshnjak 2	Boshnjak 3	Turk 1	Turk 2	Goran	
Quotation	259.381	169.410	93.165	92.611	77.002	60.676.000	51.385.000	51.380.000	4.000.000	3.661.000	939.000	73.000	21.524	1.025	761	489	531	4251	3412	984	3451	3214	245	
1	259.381.000	169.410.000	93.165.000	92.611.000	77.002.000	60.676.000	51.385.000	51.380.000	4.000.000	3.661.000	939.000	73.000.000	21.524.000	1.025.000	761.000	489	531	4251	3412	984	3451	3214	245	
3	86.460.333	56.470.000	31.055.000	30.870.333	25.667.333	20.225.333	17.128.333	17.126.667	1.333.333	1.220.333	313.000	24.333.333	7.174.667	No seats won	253.667	163	177	1417	1137.33333	328	1150.33333	1071.33333	81.6666667	
5	51.876.200	33.882.000	18.633.000	18.522.200	15.400.400	12.135.200	10.277.000	10.276.000	800.000	732.200	187.800	14.600.000	4.304.800		152.200			850.2						
7	37.054.429	24.201.429	13.309.286	13.230.143	11.000.286	8.668.000	7.340.714	7.340.000	571.429	523.000	134.143	10.428.571	3.074.857		108.714									
9	28.820.111	18.823.333	10.351.667	10.290.111	8.555.778	6.741.778	5.709.444	5.708.889	Threshold 5%			8.111.111	2.391.556		84.556									
11	23.580.091	15.400.909	8.469.545	8.419.182	7.000.182	5.516.000	4.671.364	4.670.909				6.636.364												
13	19.952.385	13.031.538	7.166.538	7.123.923	5.923.231	4.667.385	3.952.692	3.952.308				5.615.385												
15	17.292.067	11.294.000	6.211.000	6.174.067	5.133.467	4.045.067						4.866.667												
17	15.257.706	9.965.294	5.480.294	5.447.706	4.529.529							4.294.118												
19	13.651.632	8.916.316	4.903.421	4.874.263	4.052.737							3.842.105												
21	12.351.476	8.067.143	4.436.429	4.410.048	3.666.762							3.476.190												
23	11.277.435	7.365.652	4.050.652	4.026.565	3.347.913																			
25	10.375.240	6.776.400	3.726.600	3.704.440	3.080.080																			
27	9.606.704	6.274.444	3.450.556	3.430.037	2.851.926																			
29	8.944.172	5.841.724	3.212.586	3.193.483	2.655.241																			
31	8.367.129	5.464.839	3.005.323	2.987.452	2.483.935																			
33	7.860.030	5.133.636	2.823.182	2.806.394	2.333.394																			
35	7.410.886	4.840.286	2.661.857	2.646.029	2.200.057																			
37	7.010.297	4.578.649	2.517.973	2.503.000	2.081.135																			
39	6.650.795	4.343.846	2.388.846	2.374.641	1.974.410																			
41	6.326.366	4.131.951	2.272.317	2.258.805	1.878.098																			
43	6.032.116	3.939.767	2.166.628	2.153.744	1.790.744																			
45	5.764.022	3.764.667	2.070.333	2.058.022	1.711.156																			
47	5.518.745	3.604.468	1.982.234	1.970.447	1.638.340																			
49	5.293.490	3.457.347	1.901.327	1.890.020	1.571.469																			
51	5.085.902																							
53	4.893.981																							
55	4.716.018																							
57	4.550.544																							
59	4.396.288																							
61	4.252.148																							
63	4.117.159																							
65	3.990.477																							
67	3.871.358																							
69	3.759.145																							
71	3.653.254																							
73	3.553.164																							

100 seats	100
Guaranteed seats KS	10
Guaranteed seat for other Community	10
Total seats	120

Tabela 33: Procedura e ankesave dhe parashtrësive





## PËRFUNDIMI

Organizimi dhe mbajtja e zgjedhjeve demokratike është një nga proceset më të mëdha dhe gjithpërfshirëse.

Tashmë edhe Kosova ka traditë më organizimin e zgjedhjeve. Që nga viti 2000, kur për herë të parë pas përfundimit të luftës u organizuan Zgjedhjet për Kuvendet Komunale, e deri në vitin 2014, janë mbajtur disa procese zgjedhore.

Për këtë arsye, përmes këtij publikimi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron një pasqyrë të proceseve zgjedhore në Kosovë për këtë periudhë kohore.

Ky publikim paraqet pjesët thelbësore që e karakterizojnë procesin zgjedhor në vendin tonë, në këto vite, siç janë: sistemi zgjedhor; administrimi i zgjedhjeve; regjistrimi i votuesve; regjistrimi i partive politike dhe certifikimi i subjekteve politike; procesi i votimit; numërimin dhe rezultateve.

Përmes këtij publikimi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpreson se studiuesit do ta kenë më të lehtë punën e tyre kërkimore në fushën e zgjedhjeve. Gjithashtu, edhe subjektet politike apo organizatat e ndryshme ndërkombëtare e jo-qeveritare që merren me zgjedhjet, do të mund të mbështeten në këtë publikim të pasuruar me të dhëna.

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

324(496.51) “2000/2014”

Zgjedhjet në Kosovë : 2000-2014 / Komisioni Qendror i  
Zgjedhjeve. – Prishtinë : Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,  
2017. – 82 f. : ilustr. ; 24 cm.

**ISBN 978-9951-8942-0-3**

[www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org)

ISBN 978-9951-8942-0-3



9 789951 894203